**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

# SKELETKURRIKULI

## Për Profilin Mësimor

# KOPSHTARI

**Niveli III i KSHK**
**(1 vjeçar)**

## (Në drejtimin mësimor "Bujqësi")

**Kodi: H5-III-20**

Miratoi:

MINISTRI

**Tiranë, 2020**

## Përmbajtja:


I. **Qëllimet e arsimit profesional në profilin "Kopshtari", niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor "Bujqësi".**

II. **Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK.
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK.

III. **Plani mësimor për profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK.**

IV. **Udhëzime për planin mësimor**

V. **Udhëzime për procesin mësimor.**

VI. **Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

VII. **Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK.**

VIII. **Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

IX. **Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

X. **Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK, të drejtimit "Bujqësi".

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin "Kopshtari" niveli III i KSHK, të drejtimit "Bujqësi", është *"zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me kopshtarinë".* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t'u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t'i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t'u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t'u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profili "Kopshtari", niveli III i KSHK.

### 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin "Fermer", niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor "Kopshtari" niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor "Bujqësi", niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional "Kopshtari", niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efiçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

**3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor "Kopshtari", niveli III i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional "Kopshtari", niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të kopshtarisë.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet e kopshtarisë.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të kopshtarit.
- Të zbatojë teknikat e ngritjes së kopshtit.
- Të mbjellë në mënyrë estetike kulturat kopshtare në kopshtin familjar të hapur.
- Të sistemojë estetikisht kopshtet familjare dhe të hapura.
- Të zbatojë agroteknologjinë e kultivimit të kulturave kopshtare.
- Të përpunojë prodhimin e kulturave kopshtare të ndryshme.
- Të mirëmbajë kopshtet dhe hapësirat e gjelbra.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës të kopshtarisë.
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në kopshtari.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve në kopshtari.

## III. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Kopshtari", niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin "Kopshtari", niveli III i KSHK, e pajis

nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në ndërmarrje publike ose biznese private të kopshtarisë, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore, si dhe për t'u vetëpunësuar në veprimtari që lidhen me kopshtarinë. Mbas një përvoje pune dhe trajnimeve të mëtejshme, ai mund të krijojë një biznes të vogël në punimet dhe shërbimet që kryhen në fushën e kopshtarië dhe të punësojë të tjerë në të.
Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV të KSHK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin "Bujqësi", për të fituar diplomën e "Maturës Shtetërore Profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

## III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor "Kopshtari", niveli III i KSHK

| **Plani mësimor për profilin mësimor "Kopshtari", niveli III i KSHK** | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr** | **Kodi** | **Lëndët dhe modulet mësimore** | **Orët javore/ Vjetore** |
| | | | **Klasa 12** |
| **A.** | | **Lëndët e përgjithshme** (Gjithsej) | **8/9** (272/306) |
| 1 | | Gjuhë shqipe | 1 |
| 2 | | Letërsi | 1 |
| 3 | | Gjuhë e huaj e parë | 2 |
| 4 | | Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë) | (1) |
| 5 | | Matematikë | 2 |
| 6 | | TIK | 1 |
| 7 | | Edukim fizik, sporte, shëndet | 1 |
| **B.** | | **Lëndët profesionale** (Gjithsej) | **7 (238)** |
| 1 | L-17-157-20 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-14-544-20 | Njohuri bazë të kopshtarisë | 3 |
| 3 | L-14-545-20 | Kulturat kopshtare | 2 |
| **C.** | | **Module të detyruar të praktikës profesionale** (Gjithsej) | **12 (408)** |
| 1 | M-14-907-20 | Punime për ngritjen e kopshtit | 85 |
| 2 | M-14-1682-20 | Sistemimi estetik i kopshteve familjare të hapura | 85 |
| 3 | M-14-1683-20 | Agroteknologjia e kultivimit të kulturave kopshtare | 102 |
| 4 | M-14-1684-20 | Përpunimi i prodhimit të kulturave kopshtare | 85 |
| 5 | M-14-911-20 | Mirëmbajtja e kopshteve dhe e hapësirave të gjelbra | 51 |
| **D.** | | **Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar** (Gjithsej) | **3 (102)** |
| 1 | M-14-909-20 | Kultivimi i bimëve aromatike mjekësore në kopsht | 51 |
| 2 | M-14-910-20 | Përdorimi i luleve natyrale të freskëta dhe të thara | 51 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | M-14-913-20 | Mbjellja e kulturave kopshtare në objekte rrethanore | 51 |
| 4 | M-14-1685-20 | Teknika e shtimit me copa të kulturave kopshtare | 51 |
| | | **Gjithsej A+B+C+D** | **30/31 (1020/ 1054)** |

## IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)
Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).
Një orë mësimore zgjat 45 minuta.
Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Kopshtari”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për profilet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.
E rëndësishme është që ***planifikimi i mësimdhënies*** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integrimit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.
Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Kopshtari”, niveli III i KSHK.
Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti

dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.
Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilin profesional "Kopshtari".

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.
Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor "Kopshtari", niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;
Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e ndërtimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

## VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor "Kopshtari", niveli III i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor "Kopshtari", niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:
a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
b) Të dhëna për rezulatet e arrritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale,
- rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda "Bazat e sipërmarrjes" (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12, nxënësit duhet:
- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontektin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontektin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efiçiencë burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Bazat e sipërmarrjes", kl.12 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 2** | Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse | 3 orë |
| **Tema 3** | Vetvlerësimi i potencialit personal | 3 orë |
| **Tema 4** | Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive | 4 orë |
| **Tema 5** | Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja | 4 orë |
| **Tema 6** | Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve | 3 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 7** | Etika e komunikimit dhe negocimit | 4 orë |
| **Tema 8** | Puna individuale dhe puna në grup | 4 orë |
| **Tema 9** | Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi | 3 orë |
| **Tema 10** | Përgjegjësia individuale dhe shoqërore | 3 orë |
| **Tema 11** | Menaxhimi efiçient i burimeve | 3 orë |
| **Tema 12** | Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes | 3 orë |
| **Tema 13** | Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale | 5 orë |
| **Tema 14** | Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale | 3 orë |
| **Tema 15** | Format e organizimit të sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 16** | Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj. | 6 orë |
| **Tema 17** | Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve | 5 orë |
| **Tema 18** | Marrëdhëniet e punës | 4 orë |

## 2. Lënda "Njohuri bazë të kopshtarisë" (L-14-544-20). Kl. 12 – 102 orë

- **Synimet e lëndës "Njohuri bazë të kopshtarisë", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Njohuri bazë të kopshtarisë ", kl.12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë tokën bujqësore, morfologjinë dhe proflin e tokës bujqësore.
- Të përshkruajnë lëndën organike në tokë, burimet, përbërësit e humusit në tokë dhe masat agroteknike për përmirësimin e strukturës së tokës.
- Të përshkruajnë koloidet e tokës, aftësinë thithëse të koloideve dhe llojet e thithjes.
- Të shpjegojnë reaksionnin (ph) e tokave dhe mënyrat për përmirësimin e tij, si dhe aftësinë buferike të tokave.
- Të interpretojë veçoritë e përgjithshme të tokës, si dhe veçoritë fiziko-mekanike të saj.
- Të klasifikojnë tokat sipas kriterit empirik, agrogjeologjik dhe gjenetiko-agronomik.
- Të përshkruajnë hapat teknologjikë të punimeve bazë dhe sipërfaqësore të tokës.
- Të përshkruajnë hapat teknologjikë të plehërimit organik e kimik, plehërimit të lëngshëm, plehërimit të gjelbër e bakterial.
- Të përshkruajnë hapat teknologjikë të kullimit, sistemimit dhe ujitjes së tokave bujqësore.
- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe vlerat ekonomiko-shoqërore të kopshteve.
- të përshkruajnë llojin, ndërtimin dhe përdorimet e veglave, pajisjeve dhe mjeteve të kopshtarisë.
- Të përshkruajnë kopshtet tradicionale dhe bashkëkohore.
- Të klasifikojnë kopshtet sipas madhësisë, përdorimit, llojit të kulturës kopshtare etj, si dhe ndikimin e faktorëve klimatik në kulturat kopshtare.
- të vlerësojnë elementet e përshtatshmërisë së tokës për ndërtimin e kopshteve familjare në mjedise të hapura dhe të mbyllura (serra, shtretër, tunele etj.).
- të përshkruajnë proceset e përgatitjes së tokës për kultivimin e kulturave kopshatre sipas kushteve klimatiko-tokësore dhe leverdisë ekonomike, si dhe cilësitë fiziko-kimike të farave që do të mbillen në kopsht.
- të hartojnë skemën e qarkullimit të kulturave kopshtare për ruajtjen e pjellorisë së tokës.

- të përshkruajnë sëmundjet, dëmtuesit dhe barishtet e këqija, dëmin bujqësor e ekonomik, si dhe masat e luftimit të tyre.
- të përshkruajnë funksionin dhe kriteret ekonomiko-sociale mbi të cilat krijohet një kopsht familjar.
- të përcaktojnë kulturat që do të mbillen në kopshtin familjar të hapur/të mbyllur si perime, bimë arash, pemë frutore, lule dhe bimë dekorative, aromatike e mjekësore.
- të kryejnë llogaritje të thjeshta të shpenzimeve që bëhen për krijimin dhe përdorimin e kopshtit familjar në mjedis të hapur dhe të mbyllur.
- Të tregojnë lidhjen e kopshteve me agroturizmin e ditëve të sotme.
- të përshkruajnë teknikën kopshtare dhe mundësitë e mekanizimit të proceseve të punës në kopshtari,
- të planifikojnë punimet ditore, periodike dhe vjetore të kopshtit familjar të hapur dhe të mbyllur.
- të përshkruajnë organizimin dhe pajisjet e ekonomisë familjare.
- të përzgjedhin pajisjet për çdo mjedis të shtëpisë sipas përdorimit dhe preferencave në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës në familje.
- të planifikojnë punimet ditore dhe periodike të rregullimit në ekonominë familjare.
- të bëjnë organizimin e punëve në ekonominë familjare sipas numrit, gjinisë, moshës dhe gjendjes shëndetësore të pjestarëve të familjes.
- të përshkruajnë kushtet higjieno-sanitare në ekonominë familjare.
- të përshkruajnë nevojat ushqimore të anëtarëve të familjes sipas grupmoshave, si dhe mundësitë e plotësimit të tyre me prodhimet e kopshtit të tyre familjar.
- të përshkruajnë burimet e të ardhurave familjave.
- të planifikojnë shpenzimet që do të bëhen për prodhimet në kopsht, si dhe për plotësimin e nevojave të ndryshme familjare.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Njohuri bazë të kopshtarisë", kl 12 - 102 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Toka bujqësore dhe morfologjia e saj. Profili i tokës | 5 orë |
| **Tema 2** | Përbërja kimike dhe reaksioni i tokave. Veçoritë fizike kryesore dhe klasifikimi i tokave | 9 orë |
| **Tema 3** | Teknologjia e punimit dhe plehërimit të tokës | 10 orë |
| **Tema 4** | Teknologjia e kullimit, sistemimit dhe ujitjes së tokës | 10 orë |
| **Tema 5** | Rëndësia ekonomike dhe shoqërore e kopshteve | 2 orë |
| **Tema 6** | Veglat, pajisjet dhe mjetet që përdoren në kopshtari | 2 orë |
| **Tema 7** | Klasifikimi dhe madhësia e kopshteve. Ndikimi i faktorëve klimatik në kulturat kopshtare | 6 orë |
| **Tema 8** | Përshtatshmëria e tokës dhe e klimës për ndërtimin e kopshtit familjar të hapur dhe të mbyllur | 6 orë |
| **Tema 9** | Përgatitja e tokës për kultivimin e kulturave kopshtare. | 6 orë |
| **Tema 10** | Përzgjedhja e kulturave kopshtare dhe cilësitë fiziko-kimike të farës | 6 orë |
| **Tema 11** | Qarkullimi dhe mbrojtja e kulturave kopshtare | 10 orë |
| **Tema 12** | Krijimi dhe shfrytëzimi i kopshtit familjar dhe agroturizmi. | 10 orë |
| **Tema 13** | Teknika kopshtare dhe programi stinor i punimeve në kopsht. | 8 orë |
| **Tema 14** | Organizimi dhe pajisjet e ekonomisë familjare | 4 orë |

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 15** | Higjiena, ushqimet dhe shëndeti në ekonominë familjare | 4 orë |
| **Tema 16** | Ekonomizimi i ekonomisë familjare | 4 orë |

## 3. Lënda "Kulturat kopshtare" (L-14-545-20). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës "Kulturat kopshtare", kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Kulturat kopshtare", klasa 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë, rolin, klasifikimin dhe agroteknologjinë e kulturave kopshtare zbukuruese në mjedis dhe jetën e njeriut.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të kulturave kopshtare zbukuruese (një, dy dhe shumëvjeçare).
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e bimëve zbukuruese qepore, zhardhokore dhe rizomatore, si gladiola, lulepatatja, narciza, shpatorja, zambaku (Lilium), zymbyli, kalla.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e bimëve zbukuruese shkurrore (trëndafili), si dhe pemëve gjethore dhe halore.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë kulturave të arave si patatja, fasulja, luledielli, misrit të ëmbël për gatim kikirikut për fara etj., që mund të mbillen në kopsht.
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kulturave frutore në kopsht të tilla si hardhia, farore, bërthamore, fruta të vegjël si luleshtrydhe, manaferra, boronicë etj..
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kulturave perimore në mjedise të hapur dhe të mbyllur si perime frutore, gjethore, lulore etj..
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore .
- Të përshkruajnë agroteknologjinë e bimëve zbukuruese të destinuara për prerje si karafili, trandafili, gardenja, zambaku i bardhe, gladiola, lule kambana, fresie, narcize, gerbera, krizantema, ylli i krishtelindjes, tulipani, zymbyli, si dhe gipsofile, fiere, asparagus, për gjethe të ndryshme halore, fletore, gjethe bashkë me kërcejtë dhe lulerinë e tyre etj.
- Të theksojnë kriteret e përzgjedhjes së bimëve dhe materialeve ndihmëse (zgara metalike ose rrjeta teli e nikeluar, enë mbajtëse tip tavë, mbeshtjellese, letër me ngjyra të ndryshme, mbështjellëse rrjete, fjongo e lidhëse të tjera) për kompozimin e buqetave, sipas qëllimit të përdorimit të tyre.
- Të përshkruajnë agrotekniken e bimëve zbukuruese për ambjente të brendshme (fikus, bonsai, orkide, dracaena, shqiponja, palma, gjethemisri, çiklamini, kalanchoe, begonia, ylli i krishtelindjes, kaktus.etj).
- Të llogarisin koston e prodhimit të bimëve zbukuruese të destinuara për ambjente të brendshme.
- Të përshkruajnë rolin dhe qëllimin e shfrytëzimit të hapësirave të gjelbra, si dhe elementët përbërës të tyre.
- Të zbatojnë projekte të thjeshta për krijimin e hapësirave të gjelbra sipas qëllimit të shfrytëzimit të tyre me elementet përbërës të projektimit (linja, forma, ngjyra, tekstura, proporcioni, rregulli, perseritja, uniteti).
- Të shpjegojnë lidhjen e kopshteve dhe të hapësirave të gjelbra me ekoturizmin në ditët e sotme.

- Të kombinojnë bimët zbukuruese me njëra-tjetrën në hapësira të gjelbra duke ruajtur efekti e ngjyrës në mjedis.
- Të përshkruajnë llojet, mënyrën e kultivimit të barit, si dhe kombinimin e tij me bimët e tjera zbukuruese për krijimin e hapësirave të gjelbra.
- Të përshkruajnë shërbimet që kryhen për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, si dhe masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve e dëmtuesve të kulturave të mbjella në to.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Kulturat kopshtare" kl. 12 - 68 orë**

| | | |
|---|---|---|
| **Tema 1** | Rëndësia, roli, klasifikimi dhe agroteknologjia e bimëve zbukuruese. | 5 orë |
| **Tema 2** | Agroteknologjia e bimëve zbukuruese barishtore një, dy, shumëvjecare. | 6 orë |
| **Tema 3** | Agroteknologjia e bimëve zbukuruese shkurrore, pemët gjethore dhe halore. | 4 orë |
| **Tema 4** | Agroteknologjia e kultivimit të kulturave të arave në kopsht. | 4 orë |
| **Tema 5** | Agroteknologjia e kultivimit të kulturave frutore në kopsht. | 6 orë |
| **Tema 6** | Agroteknologjia e kultivimit të kulturave perimore në kopsht. | 5 orë |
| **Tema 7** | Agroteknologjia e kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore në kopsht. | 6 orë |
| **Tema 8** | Vleftshmëria ekonomike e prodhimit të kulturave kopshtare. | 2 orë |
| **Tema 9** | Bimët zbukuruese të destinuara për prerje. | 5 orë |
| **Tema 10** | Zgjedhja e bimëve dhe materialeve ndihmëse për buqeta. | 5 orë |
| **Tema 11** | Prodhimi i bimëve zbukuruese për ambjente të brendshme. Llogaritja e kostos | 4 orë |
| **Tema 12** | Rëndësia, roli dhe elementët e hapësirave të gjelbra. | 4 orë |
| **Tema 13** | Projektimi i hapësirave të gjelbra. Ekoturizmi | 5 orë |
| **Tema 14** | Mënyrat e kombinimit të bimëve zbukuruese dhe barit. | 3 orë |
| **Tema 15** | Përkujdesja për hapësirat e gjelbra. | 4 orë |

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli ”Punime për ngritjen e kopshtit”

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Kopshtari**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PUNIME PËR NGRITJEN E KOPSHTIT** | **M-14-907-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për zbatimin e teknikave të thjeshta të skicimit të kopshtit në letër, ngritjen reale të kopshtit, si dhe llogaritjen e shpenzimeve në ngritjen e tij. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 85 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi parapërgatitet për ngritjen e kopshtit.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– Të veshë uniformën e punës së kopshtarit.<br>– Të përzgjedhë vendin për ngritjen e kopshtit, sipas kushteve klimatiko-tokësore.<br>– Të përzgjedhë veglat, mjetet e materialet e nevojshme për ngritjen e kopshtit.<br>– Të analizojë faktorët klimatik të zonës ku do të ngrihet kopshti si temperatura, lagështira, orientimi gjeografik.<br>– Të analizojë rezultatet e analizës së përbërjes mekanike e kimike e tokës për ngritjen e kopshtit.<br>– Të përcaktojë madhësinë e kopshtit, sipas qëllimit të ngritjes së tij (familjar. park publik, etj.).<br>– Të përcaktojë formën e mbajtjes së kopshtit (tradicionale, bashkëkohore).<br>– Të përcaktojë lloji e kopshtit (simetrik, asimetrik dhe formë e lirë, mono apo poli kulturë).<br>– Të përcaktojë llojet e kulturave kopshtare për tu mbjellë në kopsht si: lule, perime, pemë frutore, bimë zbukuruese, bimë arash etj.<br>– Të përcaktojë distancat e mbjelljes sipas veçorive të |

kulturave që përzgjidhen për tu mbjellë.
- Të kominikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së parapërgatitjeve për ngritjen e kopshtit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për ngritjen e kopshtit.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 2 Nxënësi projekton modele të thjeshta kopshtesh.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- Të përcaktojë shkallën e zvoglimit dhe të zmadhimit sipas kahut të projektimit p.sh.: 1cm në skicë t'i përgjigjet 1m në terren etj.
- Të përcaktojë llojin të kopshtit: simetrik, asimetrik dhe kompozim i lirë.
- Të përgatisë skicën e kopshtit, sipas parametrave të përcal më
 parë për forma të ndryshme gjeometrike.
- Të përcaktojë dhe skicojë elementët strukturë të kopshtit si: qendrën e kopshtit, rrugët, vendet çlodhëse, radhën e mbjelljeve, kombinimi i bimëve në mbjellje etj.
- Të parcelizojë sipërfaqen e kopshtit, në distanca që lejojnë kalimet midis tyre, në forma të ndryshme gjeometrike, të ngritura ose jo nga toka.
- Të përgatisë planin e mbjelljes për çdo parcelë të kopshtit:
  - Çfarë -lloji i bimës (lule, perime, drufrutorë, bimë zbukuruese, bimë arash etj.)
  - Ku – parcela dhe vendi i caktuar brenda në parcelë.
  - Sa – numrin e bimëve brenda llojit (sa lloje druftorë, perimesh, lulesh a bimë të tjera aromatike/mjekësore dhe zbukuruese).
  - Si – mënyrat e mbjelljes me shpërndarje, me rreshta, me gropa etj.
  - Kur – afatet kohore të përcaktuara të mbjelljes së tyre.
- Të shfrytëzojë software specifike kompjuterike për modelimin e kopshtit, sipas mundësive që ka shkolla.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së projektimit të modeleve të tjeshta të kopshteve.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes

së mjedisit gjatë kryerjes së projektimit të modeleve të tjeshta të kopshteve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 3 Nxënësi zbaton teknikën e ngritjes së kopshtit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e punës së kopshtarit.
- Të përgatisë veglat, materialet dhe vendin ku do të mbillen kulturat kopshtare.
- Të sigurojë materialin mbjellës të nevojshëm si fara, fidanë, copa, kalema, qepujka etj., dhe ta ruajë atë në kushtet e caktuara për ruajtjen e tyre.
- Të pastrojë vendin ku do të ngrihet kopshti nga gurët, shkurret dhe mbetjet e tjera bimore.
- Të piketojë sipërfaqen e tokës ku do të ndërtohet kopshti sipas madhësisë dhe formës gjeometrike të dëshiruar..
- Të piketojë rreshtat për mbjellje dhe distancat e bimëve brenda rreshtit, sipas modelit.
- Të transportojë me shumë kujdes materialin mbjellës si fara, fidanë, copa, kalaema, qepujka etj, në parcela.
- Të mbjellë materialin mbjellës sipas veçorive të kulturave kopshtare duke respektuar planin e mbjelljes së tyre në modelin e krijuar.
- Të kryejë përkujdesjet menjëherë pas mbjelljes si: ujitje, kontrolli i zënies, zëvendësimi i bimëve, etj.
- Të kryejë shërbimet agroteknike gjatë ciklit bimor sipas qëllimit përfundimtar të kultivimit të tyre.
- Të pastrojë vendit pas kryerjes së punimeve të ngritjes së kopshtit.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës së ngritjes së kopshtit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të teknikës së ngritjes së kopshteve.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe e të mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknikës së ngritjes së kopshteve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 4 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve për ngritjen e kopshtit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazën materiale që

nevojitet për ngritjen e kopshtit.

- të përgatisë preventivin e shpenzimeve për ngritjen e kopshtit.
- të njehsojnë koston e tyre, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e piketimit, punimit të tokës dhe të shërbimeve që kryhen në kulturat e mbjella në kopsht, sipas llojit të tyre.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport, makineri, paisje, etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale për ngritjen e kopshtit.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për ngritjen e kopshtit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul mund të trajtohet në klasë dhe në bazën prodhuese të shkollës, në mjedise apo hapësira të tjera publike, si çerdhe, kopshte, spitale, qendër industriale, sipas mundësive që ofron zona dhe rajoni ku ndodhet shkolla.<br>– Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të punëve përgatitore, projektimit të modeleve të thjeshta, punimeve të ngritjes së kopshtit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me to.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të kryerjes së punëve përgatitore, krijimit të modeleve të thjeshta, punimeve të ngritjes së kopshtit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve që përdoren gjatë punimeve të ngritjes së kopshtit.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të ngritjes së kopshtit.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të kryerjes së punimeve të ngritjes së kopshtit, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me to. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>– Baza prodhuese e shkollës.<br>– Mjete dhe instrumente piketimi si: zhallonë, metër shirit, tela |

| | |
|---|---|
| | piketimi ose spango, piketa, nivelë uji etj.<br>– Modele të gatshme skicash të kopshteve të ndryshme.<br>– Veglat dhe mjetet e punimit të tokës, impjant e mjete të tjera për ujitje, plehra kimike, plehra organike, pesticide.<br>– Pajisje kancelarie, makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e kopshtarisë (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 2. Moduli "Sistemimi estetik i kopshteve familjare të hapura"

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Kopshtari**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | | |
|---|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **SISTEMIMI ESTETIK I KOPSHTEVE FAMILJARE TË HAPURA** | | **M-14-1682-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime përgatitore të strukturimin të kopshtit, të sistemimit estetik të shtrirë në të gjithë livadhin, kopshtit të kombinuar, si dhe llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime. | | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 85 orë mësimore | | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor "Bujqësi", si dhe modulin "Punime për ngritjen e kopshtit" | | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësit kryejnë punime përgatitore për sistemimin estetik të kopshteve familjare.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– Të veshin uniformën e punës për sisteminin e kopshteve.<br>– Të përgatitin planin e punimeve për sistemimin estetik të kopshteve.<br>– Të përcaktojnë sipërfaqen e kopshteve për sistemim, sipas hapësirave të tij (zbukuruese, shlodhëse si dhe pjesa ku vendosen veglat e punës).<br>– Të përzgjedhin mjetet dhe veglat e punës që nevojiten për sistemimin estetik të kopshteve.<br>– Të transportojnë mjetet dhe veglat e punës sipas kërkesave teknike.<br>– Të interpretojnë skicën e gatshme për sistemimin estetik të kopshteve, sipas modeleve të dhëna.<br>– Të skicojnë kopshtin me përmasa së bashku me objektet dhe gjelbërimin ekzistues.<br>– Të marrin mostrën e tokës për analizë për të përcaktuar llojin e tokës.<br>– Të përcaktojnë drejtimet e horizontit (Veri, Lindje, Jug, Perëndim) me busull ose sipas orientimit të njohur | |

të objektit kryesor.
- Të përcaktojnë llojin e bimësisë (bar, bimësi e ulët, shkurre dhe drurë) që do të përdoret për sistemimin estetik të kopshteve, sipas modeleve të dhëna.
- Të komunikojnë me etikë dhe profesionalizëmgjatë kryerjes sëpunimeve përgatitore për sistemimin estetik të kopshteve.
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përgatitore të sistemimit estetik të kopshteve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 2 Nxënësit kryejnë punime të strukturimit të kopshtit familjar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të veshin uniformën e punës për kryerjen e punimeve të strukturimit të kopshtit.
- Të përgatisin siç duhet planin e punimeve të strukturimit të kopshtit.
- Të përcaktojnë vendet ku do të bëhen punimet e nëndheshme dhe të mbidheshme si: drenazhimi, sistemi elektrik dhe i gazit, sistemi i ujitjes, rrugicat dhe rrethimi i kopshtit sipas teknologjisë që i përshtatet kopshtit.
- Të përzgjedhin veglat dhe mjetet që nevojiten për kryerjen e drenazhimit, sistemi i ujitjes, rrugicat dhe rrethimi i kopshtit.
- Të hapin kanalet drenazhuese brenda kopshtit me rënie 60 - 90 cm për çdo 100 m tokë horizontale.
- Të montojnë sistemin e ujitjes brenda kopshtit sipas mënyrës që i përshtatet (me rubinet e tub gome, në formë shiu dhe me pika etj.).
- Të ndërtojnë rrugicat brenda kopshtit sipas skemës së dhënë duke përdorur gurë, guriçka, tulla, pllaka të parafabrikuara, pllaka me vrima ku në mesin e tyre mbillet bar i gjelbër, dru ose dërrasa, granil, zhavor etj.
- Të ndërtojnë vendet çlodhëse brenda kopshtit dhe tenda me bimë të gjelbëra.
- Të rrethojnë kopshtin me mur ose gardh.
- Të kontrollojnë punimet e kryera për strukturimin e kopshteve.
- Të përmirësojnë cilësinë e punimeve të strukturimit të kopshtit sipas rastit.

- Të mbajnë saktë shënimet për punimet e kryera gjatë strukturimit të kopshtit.
- Të pastrojnë vendin e punës pas kryerjes së punimeve të strukturimit të kopshtit.
- Të kujdesen dhe mirëmbajnë veglat dhe materialet e strukturimit të kopshtit.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve të strukturimit të kopshtit.
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve për strukturimin e kopshtit**.**

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësit kryen sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të veshin uniformën e duhur të punës.
- Të përzgjedhin vegla, pajisjet dhe materialet e nevojshme për sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Të përgatisin siç duhet planin e punimeve për sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Të interpretojnë skicën e gatshme të dhënë për sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Të përzgjedhin kulturat kopshtare sipas skemës së dhënë.
- Të mbjellin barin e fortë në lëndinë sipas skemës së dhënë.
- Të mbjellin kulturat kopshtare sipas skemës së dhënë.
- Të kryejnë shërbimet e menjëhershme pas mbjelljes (ujitje, sistem mbështetës, capitje etj.).
- Të kontrollojnë cilësinë e punimeve të kryera për sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Të përmirësojnë cilësinë e punimeve për sistemimin estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin sipas rastit.
- Të mbajnë saktë shënimet për punimet e kryera gjatë sistemimit estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Të pastrojnë vendin të punës pas kryerjes së punimeve të sistemimit estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Të kujdesen ndaj veglave dhe materialeve të sistemimit estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin kopshtit.
- Të komunikojnë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve të sistemimit estetik të kopshtit të shtrirë në gjithë livadhin.
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve për sistemimin estetik të kopshtit

të shtrirë në gjithë livadhin**.**

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësit realizojnë sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

– Të veshin uniformën e duhur të punës.
– Të përzgjedhin vegla, pajisjet dhe materialet e nevojshme për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të përgatisin siç duhet planin e punimeve për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të interpretojnë skicën e gatshme të dhënë për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të ndërtojnë rrugëzën me gurë, guriçka, tulla, pllaka te parafabrikuara, pllaka me vrima ku në mesin e tyre mbillet bar i gjelbër, dru ose drrasa, granil, zhavor,etj. sipas skemave të dhëna.
– të ndërtojnë vendet çlodhëse brenda kopshtit të kombinuar dhe tendat me bimë të gjelbra, sipas skemave të dhëna.
– Të përzgjedhin kulturat kopshtare sipas skemës së dhënë.
– Të mbjellin barin në lëndinë sipas skemës së dhënë.
– Të mbjellin kulturat kopshtare sipas skemës së dhënë.
– Të kryejnë shërbimet e menjëhershme pas mbjelljes (ujitje, sistem mbështetës, capitje etj.).
– Të kontrollojnë cilësinë e punimeve të kryera për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të përmirësojnë cilësinë e punimeve për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të mbajnë saktë shënimet për punimet e kryera gjatë sistemimit estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të pastrojnë vendin të punës pas kryerjes së punimeve të sistemimit estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të kujdesen ndaj veglave dhe materialeve të sistemimit estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të komunikojnë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së punimeve të sistemimit estetik të kopshtit të kombinuar.
– Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve për sistemimin estetik të kopshtit të kombinuar**.**

***Instrumentet e vlerësimit:***

– Vëzhgim me listë kontrolli.

| | | |
|---|---|---|
| | **RM 5** | **Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur.**<br>**Kriteret e vlerësimit:**<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.<br>– të hartojë preventivin e materialeve.<br>– të njehsojë koston e materialeve, sipas manualit përkatës.<br>– të njehsojë kostot për sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur.<br>– të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.<br>– të njehsojë kostot e tjera (transport, makineri, paisje etj.), sipas manualit përkatës.<br>– të përdori TIK-un në sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur si foto, video, software, etj.<br>– të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | | – Ky modul duhet të trajtohet në një mjedis të përshtatshëm në shkollë ose pranë saj.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur skica të gatshme të sistemimit estetik të kopshteve familjare të hapura, si dhe demonstrime konkrete të proceseve për sistemimin estetik të tij.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.<br>– Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të proceseve të punës për sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë edhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave e mjeteve të punës.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për sistemimin e sistemimin estetik të kopshtit familjar të hapur si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike. |
| **Kushtet e** | | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet |

| | |
|---|---|
| **e domosdoshme për realizimin e modulit** | mjedisi për krijimin e kopshtit, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme:<br>– Mjedisi për kopshtin.<br>– Vegla dhe pajisje pune për sistemimin estetik të kopshtit.<br>– Pankarta, skica të gatshme, udhëzues, katalogë etj.<br>– Farë bari ose tapet bari<br>– Bimësi e ulët (lule të ndryshme) sipas skemave<br>– Bimë shkurrore sipas skemave<br>– Pajisje për ujitje, kangjella për gardh, tulla, gurë, guriçka etj.<br>– Mjete për ndërtim stolash çlodhës etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit sistemimin estetik të kopshtit (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 3. Moduli “Agroteknologjia e kultivimit të kulturave kopshtare”

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Kopshtari**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **AGROTEKNOLOGJIA E KULTIVIMIT TË KULTURAVE KOPSHTARE** | **M-14-1683-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer zbatuar të gjithë hapat teknologjik të kultivimit të perimeve në kopshtin familjar në tokë e të ngritur nga toka, bimëve të arave, kulturave drufrutore, luleve, bimëve zbukuruese, aromatike dhe mjekësore, si dhe në llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me to. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 102 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Bujqësi”, modulin “Punime për ngritjen e kopshtit” dhe modulin “Sistemimi estetik i kopshteve familjare të hapura”. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi zbaton hapat agroteknologjik në kultivimin e perime në forma të rregullta estetike në kopshtin familjar drejtpërdrejt në tokë.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– Të veshë uniformën e duhur për zbatimin e agroteknologjisë së kulturave perimore në kopshtin familjar.<br>– Të përzgjedhë vendin për kultivimin e perimeve, sipas orientimit gjeografik dhe kritereve të tjera caktuara.<br>– Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kultivimin e perimeve në kopsht.<br>– Të hartojë planin me të gjithë hapat agroteknologjik të kultivimit të perimeve në forma të rregullta estetike që nga përgatitja e tokës deri në vljeljen e prodhimit të kulturave perimore të mbjella në kopsht.<br>– Të përcaktojë saktë radhën e zbatimit të çdo hapi agroteknoligjik të kultivimit të perimeve në kopshtin familjar nëvarësi të kulturës, drjtimit të prodhimit dhe kushteve atmosferike.<br>– Të përcaktojë format e rregullta gjeometrike të mbjelljes së perimeve si: forma katrore, drejtkëndëshe, rrethore, |

ovale etj., sipas dëshirës, kërkesës dhe mundësive që ofron zona.

- Të kompozojë një model të thjeshtë të kultivimit të perimeve në kopshtin familjar, sipas situatës së dhënë në favor edhe të peisazhit përrreth, duke respektuar elementët ndërtimorë të kopshtit dhe ato mjedisor.
- Të përcakojë llojin e kulturave perimore për tu mbjellë në kopshtin familjar.
- Të lokalizojë vendin e mbjelljes së perimeve nga pjesa tjetër e kopshtit, për kryerjen e punimeve.
- Të pastrojë vendin e caktuar për mbjellje nga gurët, mbetjet bimore etj.
- Të kryejë punimin bazë dhe punimet plotësuese të tokës për kultivimin e perimeve në kopshtin familjar, sipas planit agroteknologjik të hartuar, llojit të kulturës dhe kushteve klimatiko-tokësore.
- Të kryejë plehërimin bazë organik dhe kimik të tokës ku do të mbillen perimet, sipas planit të hartuar, tregueve të pjellorisë së tokës, llojit të kulturës perimore etj..
- Të piketojë sipërfaqen e caktuar për mbjellje dhe vendin e mbjelljes së perimeve, sipas distancave të mbjelljes në varësi të kulturës perimore dhe modelit të kompozuar.
- Të kryejë të gjitha punimet e nevojshme për përgatitjen e shtratit të mbjelljes, sipas kërkesave të kulturave perimore.
- Të kryejë mbjelljen e perimeve sipas planit të mbjelljeve dhe formave të kompozuara në model.
- Të përkujdeset për kulturat e mbjella perimore menjëherë pas mbjelljes: ujitje, capitje, kontrolli i zënies, zëvendësimi i bimëve, plehërime etj., sipas nevojës së bimëve të mbjella.
- Të kryejë prashitjen e kulturave perimore në kopshtin familjar gjatë vegjetacionit sipas planit dhe nevojës së bimës.
- Të kryejë ujitjen e kulturave perimore në kopshtin familjar gjatë vegjetacionit sipas planit dhe nevojës së bimës.
- Të kryejë plehërimin organik dhe kimik të bimëve perimore, sipas planit, kulturës dhe dozave të përdorimit të tyre gjatë periudhës së vegjetacionit.
- Të kujdeset për shëndetësimin e kulturave perimore në kopshtin familjar gjatë vegjetacionit, duke ndërhyrë sipas llojit të sëmundjes dhe dëmtuesit sipas kulturave perimore.
- Të kontrollojë pjekjes e prodhimit perimor dhe të

përcaktojë momentin e vjeljes së kulturave perimore në kopshtin familjar, në varësi të llojit të kulturës perimore, drejtimit tëprodhimit dhe kërkesës..
- Të vjelë dhe grumbullojë prodhimin e kulturave perimore në kopshtin familjar.
- Të pastrojë vendin, pas kryerjes së çdo hapi agroteknologjik tëkultivimit të perimeve në forma të ndryshme estetike në kopshtin familjar drejtpërdrejt në tokë.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve të kultivimit të perimeve në forma të ndryshme estetike në kopshtin familjar drejtpërdrejt në tokë.
- Të mbajë saktë shënim të gjithë agroteknologjike të kultivimit të perimeve në forma të ndryshme estetike në kopshtin familjar drejtpërdrejt në tokë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të hapave agroteknologjik të kultivimit të perimeve në forma të ndryshme estetike në kopshtin familjar drejtpërdrejt në tokë.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit të perimeve në forma të ndryshme estetike në kopshtin familjar familjar drejtpërdrejt në tokë.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi zbaton hapat agroteknologjik të kultivimit të perimeve në forma të rregullta estetike të ngritura nga toka, në kopshtin familjar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformën e duhur të punës për gjatë mbjelljes së perimeve në forma të rregullta estetike të ngritura nga toka në kopshtin familjar.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për ndërtimin e formave të mbjelljes dhe mbjelljes së perimeve.
- Të përzgjedhë vendin për vendosjen e formave të ngritura të mbjelljes së perimeve, sipas kërkesave të tyre për dritë dhe ushqim.
- Të përcaktojë saktë radhën e punës për mbjelljen e perimeve në forma të ngritura nga toka.
- Të përcaktojë format e rregullta gjeometrike të mbjelljes së perimeve.
- Të përcaktojë llojet e perimeve që do të mbillen në format

e ngritura nga toka.

- Të përcaktojë  përmasat fikse të formave sipas mundësive qëo fon reliefi i kopshtit.
- Të skicojë modelin e kopshtit me format përkatëse, në përshtatje me gjithçka që ofron kopshti ekzistues familjar.
- Të përzgjedhë materialin e përshtatshëm për ndërtimin e formave të caktuara (dru, metal, etj).
- Të matë dhe shënojë saktë në material, sipas përmasave fikse.
- Të përgatitë elementet përbërës të ndërtimit të formës duke respektuar përmasat: gjatësi, gjerësi dhe lartësi.
- Të montojë elementet e formës, sipas modelit dhe skicës, në vendin e përhershëm të saj.
- Të përgatitë dherishten në sasinë e duhur për mbushjen e formës.
- Të mbushë me dherishte formën e ngritur deri në nivelin e duhur.
- Të zbatojë planin e mbjelljes së perimeve në çdo formë, duke respektuar distancat dhe kompozimin e mbjelljes së tyre në forma sipas modelit.
- Të krahasojë dhe përmirësojë kopshtin real të perimeve me atë të kompozuar në model.
- Të kryejë menjëherë shërbimet pas mbjelljes së perimeve në format e caktuara në model.
- Të kryejë shërbimeve agroteknike të nevojshmegjatë rritjes deri në marrjen e prodhimit të perimeve.
- Të pastrojë vendin, pas punës pas kryerjes së mbjelljes së perimeve në forma të rregullta estetike të ngritura nga toka në kopshtin familjar.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë mbjelljes së perimeve në forma të rregullta estetike të ngritura nga toka në kopshtin familjar.
- Të mbajë saktë shënim të gjithë punimet e gjatë mbjelljes së perimeve në forma të rregullta estetike të ngritura nga toka në kopshtin familjar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë gjatë mbjelljes së perimeve në forma të rregullta estetike të ngritura nga toka në kopshtin familjar.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së perimeve në forma të rregullta estetike të ngritura nga toka në kopshtin familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi zbaton hapat agroteknologjik të kultivimit të kulturave të arave në forma estetike në kopshtin familjar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të duhura të punës.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme për kultivimin e bimëve të arave.
- Të përzgjedhë vendin për kultivimin e bimëve të arave.
- Të përcaktojë radhën e punës për kultivimin e bimëve të arave.
- Të përcaktojë format estetike të mbjelljes së bimëve të arave.
- Të përcaktojë llojet e e bimëve të arave për tu mbjellë.
- Të bëjë punimin bazë dhe plotësues të tokës.
- Të bëjë plehërimin bazë organik dhe kimik të tokës.
- Të kryejë piketimin e vendit për mbjelljen e bimëve të arave.
- Të kryejë hapjen vijave ose gropave për mbjellje, sipas llojit të bimeve të arave.
- Të kryejë mbjelljen e bimëve të arave, sipas planit, formës së caktuar dhe distancave të mbjelljes për çdo kulturë të zgjedhur për tu mbjellë.
- Të kryejë shërbimet menjëherë pas mbjelljes së bimëve të arave: ujitje, capitje, kontrolli i mbirjes etj.
- Të kryejë shërbimet agroteknike gjatë periudhës së vegjetacionit: ujitje, prashitje, rrallime, plehrime, mbrojtja e bimëve etj.
- Të pastrojë vendin, pas kryerjes së çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të bimëve të arave në forma estetike në kopshtin familjar.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë zbatimit të çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të bimëve të arave në forma estetike në kopshtin familjar.
- Të mbajë saktë shënim të gjithë hapat agroteknologjik të kultivimit të bimëve të arave në forma estetike në kopshtin familjar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të bimëve të arave në forma estetike në kopshtin familjar.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit të bimëve të arave në forma estetike në kopshtin familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi zbaton hapat agroteknologjikë të kultivimit të drufrutorë në forma estetike në kopshtin familjar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të përzgjedhë veglat, paisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e drufrutorëve.
- Të përzgjedhë vendin për mbjelljen e drufrutorëve.
- Të përcaktojë radhën e punës për mbjelljen e drufrutorëve në toka.
- Të përcaktojë format e rregullta gjeometrike.
- Të përcaktojë llojet e drufrutorëve për tu mbjellë.
- Të kryejë piketimin e vendit për mbjelljen e drufrutorëve .
- Të kryejë hapjen e gropave sipas përmasave në varësi të kulturës drufrutore.
- Të kryejë mbushjen e gropave me pleh e dhè.
- Të kryejë mbjelljen e drufrutorëve .
- Të kryerjë shërbimet menjëherë pas mbjelljes së drufrutorëve: ujitje, capitje, kontrolli i zënies, vendosje e sistenit mbështetës etj.
- Të kryerjë shërbimet agroteknike gjatë periudhës së vegjetacionit: ujitje, punime , plehrime, kujdesi për shëndetësimin e kulturave, krasitje etj.
- Të pastrojë vendin, pas kryerjes së çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të drufrutorëve në forma estetike në kopshtin familjar.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë zbatimit të çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të drufrutorëve në forma estetike në kopshtin familjar.
- Të mbajë saktë shënim të gjithë hapat agroteknologjik të kultivimit të drufrutorëve në forma estetike në kopshtin familjar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të drufrutorëve në forma estetike në kopshtin familjar.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit të drufrutorëve në forma estetike në kopshtin familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 5 Nxënësi zbaton hapat agroteknologjik të kultivimit të luleve dhe bimëve zbukuruese në kopshtin familjar**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të përzgjedhë veglat, paisjet dhe materialet e nevojshme për mbjelljen e luleve dhe bimëve zbukuruese.
- Të përzgjedhë vendin për mbjelljen e luleve dhe bimëve zbukuruese.
- Të përcaktojë radhën e punës për mbjelljen e luleve dhe bimëve zbukuruese..
- Të përcaktojë format e rregullta të mbjelljes së luleve dhe bimëve zbukuruese..
- Të përcaktojë llojet e luleve dhe bimëve zbukuruese. për tu mbjellë.
- Të kryejë piketimin e vendit për mbjelljen luleve dhe bimëve zbukuruese.
- Të përgatisë tokën për mbjelljen e luleve dhe bimëve zbukuruese.
- Të kryejë mbjelljen e luleve dhe bimëve zbukuruese.
- Të kryerjë shërbimet menjëherë pas mbjelljes së luleve dhe bimëve zbukuruese.
- Të kryerjë shërbimet agroteknike gjatë periudhës së rritjes dhe zhvillimit të luleve dhe bimëve zbukuruese.
- Të pastrojë vendin, pas kryerjes së çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të luleve dhe bimëve të zbukuruese në kopshtin familjar.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë zbatimit të çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të kultivimit të luleve dhe bimëve të zbukuruese në kopshtin familjar.
- Të mbajë saktë shënim të gjithë hapat agroteknologjik të kultivimit të kultivimit të luleve dhe bimëve të zbukuruese në kopshtin familjar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të kultivimit të luleve dhe bimëve të zbukuruese në kopshtin familjar.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit të kultivimit të luleve dhe bimëve të zbukuruese në kopshtin familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 6 Nxënësit zbaton hapat agroteknologjik të kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore në kopsht.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të përcaktojë vendit për mbjelljen e bimëve aromatike e mjekësore, sipas kritereve klimatiko-tokësore të bimëve aromatike.
- Të përzgjedhë veglat, mjetetdhe materialet e nevojshme për përgatitjen e tokës për mbjelllje.
- Të transportojë veglat, mjetet dhe materialet të përgatitjes së tokës për mbjellje në vendin e caktuar për mbjellje.
- Të kryejë plehërimin dhe punimin bazë të tokës (me krah ose me mjete mekanike), në kohën dhe cilësinë e duhur.
- Të kryejë punime dhe plehërime plotësuese të tokës, sipas tipit të tokës dhe kërkesave të bimëve aromatike e mjekësore që do të mbillen.
- Të përgatisë shtratit e mbjelljes sipas kërkesave të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të përcaktojë llojin e bimëve aromatike e mjekësore për mbjellje p.sh.: borzilok, mendër, sherebelë etj.
- Të përzgjedhë farën për mbjellje sipas elementeve cilësorë të saj.
- Të përcaktojë afatin e mbjelljes së farës në shtrat, sipas llojit të bimës dhe zonës.
- Të përkujdesen menjëherë pas mbjelljes së farës në shtrat duke kryer ujitje, plehërime, kalitjen e fidanëve etj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme deri prodhimin e fidanit.
- Të përgatisë tokën për mbjelljen e fidanëve të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të përcaktojë distancat e mbjelljes sipas llojit të bimës.
- Të piketojë vendin e mbjelljes sipas distancave të mbjelljes.
- Të bëjë artisjen e fidanëve me kujdes.
- Të mbjellë fidanët në vendin e përhershëm në kopsht.
- Të kryejë përkujdesjet pas mbjelljes fidanit në vendin e përhershëm: ujitje, plehërime, mbrojtja e bimëve etj.
- Të pastrojë vendin pas kryerjes së çdo hapi agroteknologjik të kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore  në kopshtin familjar.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve të agroteknologjisë së kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore në kopshtin familjar.
- Të mbajë saktë shënimee mbi të gjithë hapat agroteknologjik të kultivimit të bimëve aromatike e

mjekësore në kopshtin familjar.

- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore .
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të agroteknologjisë së kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore në kopshtin familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 7 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të agroteknologjisë së kulturave kopshtare.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazën materiale që nevojitet për agroteknologjinë e kulturave kopshtare.
- të hartojë preventivin e shpenzimeve sipas manualit perkatës.
- të njehsojë koston e bazën materiale që nevojitet për agroteknologjinë e kulturave kopshtare, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport, makineri, paisje, etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale për agroteknologjinë e kulturave kopshtare.
- të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për agroteknologjinë e kulturave kopshtare.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në ngastra të vogla në bazën prodhuese të shkollës ose në zonat përreth.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për zbatimin e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave kopshtare perimore, të arave, drufroturë, lule, bimëzbukuruese, bimë aromatike e mjekësore, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave të ndryshme kopshtare, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.<br>– Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave të ndryshme kopshtare, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të |

| | |
|---|---|
| | punimeve lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve për kryerjen e hapave agroteknologjik të kultivimit të kulturave të ndryshme kopshtare.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerisë dhe pajisjeve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kultivimin e bimëve aromatike në kopsht, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me to. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet ngastra e tokës bujqësore, veglat, pajisjet, dhe makineria e mëposhtme:<br>– Ngastër toke në bazën prodhuese të shkollës.<br>– Vegla dhe pajisje pune të kultivimit të kulturave kopshtare.<br>– Material mbjellës së kulturave kopshtare.<br>– Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit të tokave bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 4. Moduli "Përpunimi i prodhimit të kulturave kopshtare"

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Kopshtari**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PËRPUNIMI I PRODHIMIT TË KULTURAVE KOPSHTARE** | **M-14-1684-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të zbatuar metoda të ndryshme për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative, kryer procese të thjeshta të përpunimit të prodhimit perimor, frutave dhe prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike për to. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 85 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor "Bujqësi. | |

**Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe proçedurat e vlerësimit**

**RM 1** **Nxënësi zbaton metoda të ndryshme për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të organizojë siç duhet vendin e punës për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative për tharje.
- Të përgjedhë llojet e luleve dhe bimëve dekorative për tharje.
- Të përzgjedhë mjetet, materialet dhe vendin për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative për tharje për tharje.
- Përcaktimi i momentit të marrjes/prerjes së luleve dhe bimëve dekorative për tharje.
- Të thajë lule me metodën kokëposhtë në formë horizontale.
- Të kotrollojë për tre javë tharjen e tufave të luleve me kokë poshtë në formë horizontale.
- Të thajë lule me metodën e përdorimit të xhelit të silicit.
- Të kontrollojë pas 2 ditësh tharjen e luleve:

- nëse xheli ka marrë mgjyrë të kuqe atëherë ka përfunduar procesi i tharjes së luleve;
  - nëse xheli NUK ka marrë ngjyrë të kuqe ato mbulohen përsëri, dhe vazhdon tharja deri në 4-5 ditë.
  - nëse është tharë lulja por jo pjesa tjetër e degës, atëherë mbyulohet vetëm pjesa e patharë.
- Të thajë degët dhe gjethet e bimëve dekorative me përdorimin e glicerinës.
- Të kontrollojë vazhdimisht procesin e tharjes së degëve e gjetheve të bimëve dekorative, deri sa uji i pjesëve bimore të zëvendësohet me përzierje e glicerinës.
- Të thajë lulet dhe gjethet me metodën e presimit.
- Të kontrollojë vazhdimisht për 20-25 ditë, procesit të tharjes së luleve e gjetheve me metodën e presimit
- Të thajë lulet dhe gjethet me përdorimin e mikrovalës.
- Të kontrollojë vazhdimisht procesin e tharjes së luleve e gjetheve në mikrovalë.
- Të pastrojë vendin e punës pas përfundimit të tharjes së luleve dhe bimëve dekorative, sipas rregullave të caktuara.
- Të tregojë kujdes për veglat, pajisjet dhe materialet e tjera të tharjes së luleve dhe bimëve dekorative.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë zbatimit të metodave të ndryshme për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të metodave të ndryshme të tharjes së luleve dhe bimëve dekorative.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi kryen procese të thjeshta të përpunimit të prodhimit perimor të kopshtit familjar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të hartojë planin e vjeljeve të prodhimit perimor të kopshtit familjar, sipas kohës së pjekjes dhe drejtimit të përdorimit të tyre.
- Të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme të vjeljes së prodhimit perimor.të
- Të përcaktojë radhën e vjeljes së kulturave perimore të kopshtit.
- Të përcaktojë momentin e vjeljes së prodhimit perimor

të kopshtit, sipas drejtimit të prodhimit dhe llojit të kulturës perimore.

- Të vjelë prodhimin e kulturave perimore të kopshtit familjar sipas teknika të caktuara të vjeljes për secilën kulturë perimore.
- Të transportojë me kujdes prodhimin perimor nga kopshti në vend grumbullimin e tyre.
- Të seleksionojë dhe sistemojë prodhimn e vjelë, sipas drejtimit të përpunuar (konsum i freskët apo i përpunuar) dhe sipas kërkesës.
- Të përpunojë prodhimin perimor për konsum familjar ose treg (turshi, salcë, të thara etj), sipas standardit.
- Të amballazhojë, sipas standardit, prodhimin e perimeve të freskëta apo të përpunuara konsum familjar ose treg.
- Të tregojë kujdes gjatë ruajtjes së prodhimit perimor të freskët dhe të përpunuar, duke ruajtur parametrat e caktuar të temperaturës, lagështirës, dritës etj.).
- Të pastrojë siç duhet, vendin e punës pas përpunimit të prodhimit të perimeve të kopshtit familjar.
- Të tregojë kujdes për veglat dhe materialet e punës pas përpunimit të prodhimit perimor.
- Të llogarisë sasinë e perimeve për konsum familjar (të freskëta dhe të përpunuara), sipas nevojave të familjes.
- Të llogarisë sasinë e prodhimit perimor për treg, sipas kërkesave.
- Të llogarisë koston, shpenzimet dhe punën e kryer për kryerjen e proceseve të thjeshta të përpunimit të prodhimit perimor të kopshtit familjar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me kolegët, eprorët dhe klientët.
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe të vendit ku do të përpunohet prodhimi i perimeve të kopshtit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjesdisit gjatë kryerjes së proceseve të përpunimit të prodhimit të perimeve të kopshtit familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi kryen procese të thjeshta të përpunimit të frutave të kopshtit familjar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të hartojë planin e vjeljes së frutave të kopshtit

familjar.

- Të sigurojë veglat dhe materialet ndihmëse dhe të amballazhimit të nevojshme të vjeljes së frutave të kopshtit familjar, sipas llojit të kulturës.
- Të përcaktojë radhën e vjeljes së frutave të kopshtit familjar.
- Të përcaktojë momentin e vjeljes së frutave sipas llojit të kulturës dhe drejtimit të prodhimit.
- Të vjelë frutat e kopshtit familjar sipas teknikave të caktuara të vjeljes për secilën kulturë perimore (luleshtrydhe, fiq, rrush, mollë, dardhë, qershi, pjeshkë, hide, shegë, ftua etj.).
- Të transportojë me kujdes frutat e vjela nga kopshti në vend grumbullimin e tyre.
- Të seleksionojë dhe sistemojë frutat e vjelë, sipas drejtimit të përdorimit (konsum i freskët apo i përpunuar) dhe sipas kërkesës.
- Të përpunojë frutat për konsum familjar ose treg (lëng të freskët, reçel, komposta, të thara etj), sipas standardit të përpunimit.
- Të amballazhojë, sipas standardit, frutat e freskëta apo të përpunuara për konsum familjar ose treg.
- Të tregojë kujdes gjatë ruajtjes së frutave të freskët dhe të përpunuar, duke ruajtur parametrat e caktuar të temperaturës, lagështirës, dritës etj.).
- Të pastrojë siç duhet, vendin e punës pas përpunimit të frutave të kopshtit familjar.
- Të tregojë kujdes për veglat dhe materialet e punës pas përpunimit të frutave.
- Të llogarisë sasinë e frutave për konsum familjar (të freskëta dhe të përpunuara), sipas nevojave të familjes.
- Të llogarisë sasinë e frutave për treg, sipas kërkesave.
- Të llogarisë koston, shpenzimet dhe punën e kryer për kryerjen e proceseve të thjeshta të përpunimit të frutave të kopshtit familjar.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me kolegët, eprorët dhe klientët.
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe të vendit ku do të përpunohen frutat e kopshtit.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjesdisit gjatë kryerjes së proceseve të përpunimit të frutave të kopshtit familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi kryen procese të thjeshta të përpunimit të prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të hartojë planin e vjeljes së prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar, sipas llojit të kulturës (patate, fasule, misër i ëmbël për gatim, luledielli etj).
- Të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme të vjeljes së prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar, sipas llojit të kulturës.
- Të përcaktojë radhën e vjeljes së prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar, sipas llojit të kulturës
- Të përcaktojë momentin e vjeljes së prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar sipas llojit të kulturës dhe kërkesës.
- Të vjelë prodhimin e bimëve të arave të kopshtit familjar sipas teknikave të caktuara të vjeljes për secilën kulturë (patate, misër i ëmbël, fasule, bizele, batthë, luledielli etj.).
- Të transportojë me kujdes prodhimin e bimëve të arave nga kopshti në vend grumbullimin e tyre.
- Të seleksionojë dhe sistemojë prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar, sipas nevojave apo kërkesave.
- Të përpunojë prodhimin e bimëve të arave të kopshtit familjar për konsum familjar ose treg, sipas standardit të përpunimit.
- Të amballazhojë, sipas standardit, prodhimin e bimëve të arave për konsum familjar ose treg.
- Të tregojë kujdes gjatë ruajtjes së prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar, duke ruajtur parametrat e caktuar të temperaturës, lagështirës, dritës, mbrojtje nga dëmtuesit etj.).
- Të pastrojë siç duhet, vendin e punës pas përpunimit të prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar.
- Të tregojë kujdes për veglat dhe materialet e punës pas përpunimit të prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar.
- Të llogarisë sasinë e prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar për konsum familjar, sipas nevojave.
- Të llogarisë sasinë e prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar për treg, sipas kërkesave.
- Të llogarisë koston, shpenzimet dhe punën e kryer për kryerjen e proceseve të thjeshta të përpunimit të

| | |
|---|---|
| | prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar.<br>– Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me kolegët, eprorët dhe klientët.<br>– Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe të vendit ku do të përpunohet prodhimi i bimëve të arave të kopshtit familjar.<br>– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjesdisit gjatë kryerjes së proceseve të përpunimit të prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në pika të përpunimit të perimeve frutave dhe bimëve të arave, pranë shkollës.<br>– Gjatë trajtimit të modulit mësuesi i praktikës ose specialisti teknolog, duhet të përdorë sa më shumë demostrime konkrete të zbatimit të metodave të ndryshme për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative, kryerjen e proceseve të thjeshta të përpunimit të prodhimit perimor, të frutave dhe prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike për to.<br>– Nxënësit duhet të praktikohen sa më shumë të jetë mundur për kryerjen e proceseve të punës të punës për të zbatuar metoda të ndryshme për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative, kryer procese të thjeshta të përpunimit të prodhimit perimor, frutave dhe prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta të zbatimit të metodave të ndryshme për tharjen e luleve dhe bimëve dekorative, kryerjes së proceseve të thjeshta të përpunimit të prodhimit perimor, të frutave dhe prodhimit të bimëve të arave të kopshtit familjar.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për përpunimin e prodhimit të kulturave kopshtare.<br>– Mësuesi i praktikës ose specialisti i përpunimit tëprodhimit tëkulturave kopshtare, duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të përpunimit të prodhimit të kulturave kopshtare, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike në lidhje me to. |

| | |
|---|---|
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>– Ferma e shkollës.<br>– Mjete e materiale bazë dhe ndihmëse të përpunimit të prodhimit tëkulturave kopshtare.<br>– Lule dhe bimë të ndryshme dekorative.<br>– Perime të ndryshme<br>– Fruta të ndryshëm<br>– Bimë arash të ndryshme.<br>– mikrovalë, dhomë apo dollape për tharjen e luleve e bimëve dekorative.<br>– Xhel silici, glicerinë, mikrovalë, libra, gazeta, tabakë etj<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Udhëzues, kataloge, rregullore, standarde në lidhje me përpunimin e prodhimit të kulturave kopshtare.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos. |

## 5. Moduli Mirëmbajtja e kopshteve dhe e hapësirave të gjelbra

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Kopshtari**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **MIRËMBAJTJA E KOPSHTEVE DHE E HAPËSIRAVE TË GJELBRA** | **M-14-911-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime të pastrimit të mjedisit, kositjes së barit, mirëmbajtjes së kurorës, mbrojtjes së bimëve dekorative e pemëve në kopsht dhe hapësira të gjelbëra, si dhe të kryerjes së llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor "Bujqësi". | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi pastron kopshtin dhe hapësirat e gjelbëra para dhe pas lulëzimit të bimëve.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jenë të aftë:<br>– Të vëzhgojë mjedisin e kopshtit për pastrimin e tij.<br>– Të përzgjedhë mjetet dhe veglat e nevojshme të punës për pastrimin e kopshtit/hapësirave të gjelbëra (fshesa, krëhëra, thasë, karroca dore etj.)<br>– Të transportojë me krah mjete dhe veglat të punës në kopsht.<br>– Të përcaktojë kohën e kryerjes së së pastrimit të kopshtit/hapësirave të gjelbëra (mëngjes ose mbrëmje).<br>– Të pastrojë mjedisin e kopshtit/hapësirave të gjelbëra duke grumbulluar mbetjet bimore si gjethe, degë, lule etj.<br>– Të kryejë largimin e mbeturinave bimore nga kopshti/hapësirave të gjelbëra në vendin e grumbullimit të tyre (fundi i kopshtit për kompostimin e tyre).<br>– Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë pastrimit të kopshteve/hapësirave të gjelbëra. |

*Instrumentet e vlerësimit:*

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi kosit barin në kopshte dhe hapësira të gjelbëra.**

*Kriteret e vlerësimit:*

Nxënësi duhet të jenë të aftë:

- Të kositë barin me kosë në kopsht, sipas kritereve të caktuara.
- Të thajë barin në kopsht për 2-3 ditë.
- Të kthejë në mënyrë të vazhdueshme barin deri në tharjen e tij të plotë.
- Të grumbullojë barin e thatë në grumbuj të vegjël.
- Të largojë barin e thatë nga kopshti në destinacion: për ngrënie për kafshët ose për ruajtje.
- Të përdorë motokorrëses për kositjen e barit në kopsht dhe në hapësira të gjelbëra.
- Të grumbullojë barin e kositur në kopsht apo hapësira të gjelbëra, në grumbuj të vegjël.
- Të largojë barin e grumbulluar me krah ose mjete mekanike nga kopshti apo hapësirat e gjelbëra.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kositjes së barit në kopsht dhe në hapësira të gjelbëra.

*Instrumentet e vlerësimit:*

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi kujdeset për mirëmbajtjen e bimëve dekorative dhe pemëve në kopshte e hapësira të gjelbëra.**

*Kriteret e vlerësimit:*

Nxënësi duhet të jenë të aftë:

- Të përzgjedhë veglat dhe mjetet e nevojshme të mirëmbajtjes së formave të bimëve zbukuruese dhe pemëve, në kopsht e hapësira të gjelbëra.
- Të identifikojë bimët dekorative dhe pemët për krasitjen e tyre.
- Të përcaktojë formën e kurorës në figura të rregullta gjeometrike si :katrore, rrethore, katrore e shkallëzuar, imitim i formave të kafshëve etj, si dhe në formë të lirë rritjes së tyre, ndërsa pemët frutore në mbahen formë kupore, palmetë etj.
- Të kryejë krasitjen dimërore të bimëve zbukuruese dhe pemëve, në formën e caktuar të kurorës në përputhje me llojin e bimës.
- Të realizojë krasitje vegjetative të bimëve zbukuruese dhe pemëve, për një ajrim dhe ndriçim më të mirë të kurorës së

bimëve bukuruese dhe pemëve.
- Të grumbullojë dhe largojë mbetjet bimore gjatë krasitjes nga kopshti dhe hapësirave të gjelbëra.
- Të vendosë sistem mbështetës për mbajtjen e degëve të bimë zbukuruese dhe pemëve sipas nevojës së tyre.
- Të zbatojë format më të përshtatshme të ujitjes së bimëve dhe pemëve në kopsht e në hapësira të gjelbëra, sipas kërkesave dhe nevojave të bimëve.
- Të kryejë punimin e tokës përreth rreth trungjeve të bimëve zbukuruese e pemëve në kopsht e hapësira të gjelbëra.
- Të kryejë plehërimin me plehëra organike e kimike të bimëve e pemëve në kopshte dhe hapësirave të gjelbëra sipsa kërkesave të tyre për elementë ushqyes.
- Të kryejë pastrimin dhe ruajtjen e mjedisit gjatë kujdesit dhe  mirëmbajtjes së bimëve të kopshtit
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së bimëve dekorative dhe pemëve në kopsht e hapësira të gjelbëra.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi mirëmban bimësinë e kopshtit dhe hapësirave të gjelbëra nga sëmundjet dhe dëmtuesit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jenë të aftë:
- Të vëzhgojë mjedisin e kopshtit dhe të hapësirave të gjelbëra për sëmundje e dëmtues.
- Të identifikojë bimët e prekura nga sëmundje apo dëmtues.
- Tëdiagnostikojë sëmundjen apo dëmtuesin në bimët e prekura.
- Të përcaktojë masat e luftimit të sëmundjeve apo dëmtuesve (masa agroteknike, mekanike, kimike apo biologjike).
- Të përcaktojë metodën më optimale të luftimit të sëmundjes apo dëmtuesit sipas mënyrës së përcaktuar të luftimit (me punime të tokës, me grumbullim e djegie, lyerja e trungjeve me gëlqere, me spërkatje ose pluhurosje, me antagonizëm etj).
- Të zbatojë masat e luftimit të sëmundjes apo dëmtuesit sipas metodës optimale të përcaktuar.
- Të kryejë pastrimin e vendit të punës dhe ruajtja e mjedisit gjatë trajtimit të bimëve për sëmundje apo dëmtues
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së

mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes së bimëvë e pemëve të kopshtit dhe të hapësirave të gjelbëra.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë fletë kërkesën për bazë materiale.
- të hartojë preventivin e materialeve.
- të njehsojë koston e materialeve, sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e punimeve të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra sipas manualit përkatës.
- të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- të njehsojë kostot e tjera (transport, makineri, paisje etj.), sipas manualit përkatës.
- të llogarisë detyrimet fiskale në mirëmbajtjen e kopshteve dhe të hapësirave të gjelbëra.
- të përdorë TIK-un në mirëmbajtjen e kopshteve dhe të hapësirave të gjelbëra si foto, video, software, etj.
- të llogaritin të ardhurat dhe fitimin në punimet e mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në kopshtin/fermën e shkollës, në hapësira të gjelbëra të qytetit apo komunës pranë saj.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të punimeve për mirëmbajtjen e kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për pastrimin, kositjen e barit, mirëmbjatjes e kurorës, dhe mbrojtjene  e bimëve dhe pemëve të kopshtit dhe hapësirave të gjelbëra nga sëmundje e dëmtues, fillimisht në mbikëqyrje dhe pastaj në mënyrë të pavarur.<br>– Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike të punimeve të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë dhe përdorimin e mirëmbajtjen e veglave dhe mjeteve që përdoren për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra. |

| | |
|---|---|
| | – Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të punimeve të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me këto punime. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet mjedisi për krijimin e kopshtit, veglat, pajisjet, dhe baza materiale e mëposhtme:<br>– Mjedisi për kopsht dhe hapësira të gjelbëra publike.<br>– Vegla dhe pajisje pune të mirëmbajtjes së kopshtit dhe të hapësirave të gjelbëra.<br>– Udhëzues, katalogë të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra.<br>– Farë bari ose tapet bari<br>– Kompleti i veglave të krasitjes.<br>– Plehëra organike e kimike.<br>– Enë apo mekanizma për ujitje.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e punimeve të mirëmbajtjes së kopshteve dhe hapësirave të gjelbëra (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1. Moduli “Kultivimi i bimëve aromatike e mjekësore në kopsht“

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Kopshtari**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| | | |
|---|---|---|
| | *PËRSHKRUESI I MODULIT* | |
| **Titulli dhe kodi** | **KULTIVIMI I BIMËVE AROMATIKE E MJEKËSORE NË KOPSHT** | **M-14-909-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer përgatitjen e shtratit të mbjelljes së farës, prodhimin e fidanit, mbjelljess së fidanit në vendin e përhershëm, shërbimet pas mbjelljese gjatë rritjes së fidanit të bimëve aromatike e mjekëosre, si dhe në llogaritjet e thjeshta ekonomike që lidhen me to. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Bujqësi”. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësit përgatit shtratin e mbjelljes së farës së bimëve aromatike e mjekësore.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësit duhet të jenë të aftë:<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të nevoshme të punës.<br>– Të përcaktojnë vendit për mbjelljen e bimëve aromatike e mjekësore, sipas kritereve klimatiko-tokësore të bimëve aromatike.<br>– Të përzgjedhin veglat, mjetet dhe materialet e nevojshme për përgatitjen e shtratit të mbjelljes së farës së bimëve aromatike e mjekësore.<br>– Të transportojnë veglat, mjetet dhe materialet e përgatitjes së shtratit të mbjellje së farës së bimëve aromatike e mjekësore, në vendin e caktuar për mbjellje.<br>– Të kryejnë plehërimin dhe punimin bazë të tokës (me krah ose me mjete mekanike), në kohën dhe cilësinë e |

duhur.

- Të kryejnë punime dhe plehërime plotësuese të tokës, sipas tipit të tokës dhe kërkesave të bimëve aromatike e mjekësore që do të mbillen.
- Të përgatitin shtratit e mbjelljes sipas kërkesave të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të pastrojnë dhe sistemojnë vendin e punës pas përgatitjes së shtratit të mbjelljes së bimëve aromatike e mjekësore.
- Të pastrojë mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatëpërgatitje së shtratit të mbjelljes.
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së shtratit të mbjelljes së bimëve aromatike e mjekësore.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësit mbjellin bimë aromatike në kopsht.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të përcaktojnë llojin e bimëve aromatike e mjekësore për mbjellje p.sh.: rosmarina, finoku, lavanda, kamomili,bari i bletes, mendra e butë ose djegëse, borziloku, rigoni i bardhë, sherebela, zhumbrica, dafina etj., në përputhje me kushtet klimatiko-tokësore.
- Të përzgjedhin farën dhe fidanët, përfshirë dhe organet shumuese vegjetative si rrënja, rizoma, prerje kërcelli etj për tu mbjellë, sipas elementeve cilësorë të tyre dhe mënyrës së shtimit të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të përcaktojnë afatin e mbjelljes së farës në shtrat, sipas llojit të bimës dhe zonës.
- Të kryejnë mbjelljen e farës në shtratin e mbjelljes, sipas teknikës së përcaktuar dhe llojit të bimës.
- Të përkujdesen menjëherë pas mbjelljes së farës në shtrat duke kryer ujitje, capitje, plehërime, kalitjen e fidanëve etj.
- Të kryejnë shërbimet e nevojshme deri prodhimin e fidanit.
- Të përgatitin tokën për mbjelljen e fidanëve të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të përcaktojnë distancat e mbjelljes sipas llojit të bimës.
- Të piketojnë vendin e mbjelljes sipas distancave të mbjelljes.
- Të bëjnë artisjen e fidanëve me kujdes.

- Të mbjellin fidanët në vendin e përhershëm në kopsht.
- Të përkujdesen menjëherë pas mbjelljes së fidanit si: ujitje, kontrolli i zënies, capitje, plehërime etj..
- Të pastrojnë vendin pas mbjelljes së bimëve aromatike e mjekësore.
- Të kujden siç duhet për veglat dhe pajisjet e punës.
- Të komunikojnë me etikë dhe profesionalizëm gjatë mbjelljes së bimëve aromatike e mjekëosre në kopsht.
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së bimëve aromatike e mjekësore në kopsht.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësit kryejnë shërbimet agroteknike gjatë rritjes së fidanëve në kopsht.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të kontrollojnë zënien e fidanëve me teknika të thjeshta të kontrollit.
- Të zëvendësojnë fidanët e pazënë me fidanë të rinj.
- Të kryejnë prashitjen e fidanëve sipas nevojave të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të kryejnë ujitjen e fidanëve të mbjellë, sipas nevojës.
- Të kryejnë plehërimet plotësuese sipas nevojave të bimëve për elementë ushqyes.
- Të kujdesen në vazhdimësi ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të zbatojnë teknika të thjeshta të vjeljes së prodhimit të bimëve aromatike e mjekësore.
- Të pastrojnë vendin e punës pas kryerjes së çdo shërbimi agroteknik.
- Të kujdesen siç duhet për veglat dhe pajisjet e punës.
- Të llogarisin koston, shpenzimet dhe punën së kryesr gjatë kultivimit të bimëve aromatike e mjekësore në kopsht.
- Të komunikojnë me etikë dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike gjatë rritjes së fidanëve të bimëve aromatike e mjekësore në kopsht..
- Të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve agroteknike gjatë rritjes së fidanëve të bimëve aromatike e mjekësore në kopsht.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | – Ky modul duhet të trajtohet në ngastra të vogla në bazën prodhuese të shkollës ose në zonat përrreth.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për përgatitjen e shtratit të mbjelljes së farës, mbjelljen e fidanit në vendin e përhershëm, kryerjen e shërbimëve agroteknike ndaj bimëve aromatike e mjekësore, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e përgatitjes së shtratit të mbjelljes së farës, mbjelljes së fidanit në vendin e përhershëm, kryerjes së shërbimëve agroteknike ndaj bimëve aromatike e mjekësore, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.<br>– Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e përgatitjes së shtratit të mbjelljes së farës, mbjelljes së fidanit në vendin e përhershëm, kryerjes së shërbimëve agroteknike, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve për përgatitjen e shtratit të mbjelljes së farës, mbjelljes së fidanit në vendin e përhershëm, kryerjes së shërbimëve agroteknike ndaj bimëve aromatike e mjekësore.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerisë dhe pajisjeve.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kultivimin e bimëve aromatike në kopsht, si dhe për llogaritje të thjeshta ekonomikelidhur me to. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet ngastra e tokës bujqësore, veglat, pajisjet, dhe makineria e mëposhtme:<br>– Ngastër toke në bazën prodhuese të shkollës.<br>– Vegla dhe pajisje pune të kultivimit të bimëve aromatike.<br>– Fara dhe fidanë të bimëve aromatike.<br>– Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e sistemimit të tokave bujqësore (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |

## 2. Moduli “Përdorimi i luleve natyrale të freskëta dhe të thara“

**Drejtimi:** **Bujqësi**
**Profili:** **Kopshtari**
**Niveli:** **III i KSHK**
**Klasa:** **12**

| *PËRSHKRUESI I MODULIT* | | | |
|---|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **PËRDORIMI I LULEVE NATYRALE TË FRESKËTA DHE TË THARA** | | **M-14-910-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për përdorimin e luleve natyrale të freskëta në buqeta e vazo, përdorimin e luleve të thata në shporta, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike të përdorimit të tyre. | | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK të drejtimit mësimor “Bujqësi”. | | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi përdor lule të freskëta natyrale për buqeta.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.<br>– Të përgatitë vendin dhe mjetet e nevojshme të punës për përgatitjen e buqetave me lule natyrale te freskëta<br>– Të grumbullojë/sigurojë sasinë dhe llojshmërine e nevojshem të luleve natyrale të freskëta për buqeta.<br>– Të sigurojë materiale të tjera bimore për përgatitjen e buqetave si, gjethe të ndryshme, kërcenj, gipsofil etj.<br>– Të shtrojë tavolinën e punës për përgatitjen e buqetave.<br>– Të kompozojë buqeta për raste të ndryshme si: datëlindje, kritshlindje e viti i ri, festa e nënës, e mësuesit, martesa, funerale etj.<br>– Të vendosë materiale të tjera bimore shtesë për gjethe të ndryshme halore, fletore, gjethe bashkë me kërcejtë dhe lulerinë e tyre etj.në buqetë, sipas një raporti të caktuar gjethe-lule.<br>– Të lidhë lulet dhe materialet e kompozuara me lidhëse të ngjyrave e formave të ndryshme. materialeve ndihmëse (zgara metalike ose rrjeta teli e nikeluar, enë mbajtëse tip tavë, mbeshtjellese, letër me ngjyra të | |

ndryshme, mbështjellëse rrjete, fjongo e lidhëse të tjera).

- Të bëjë shkurtimin e bishtave të luleve të buqetës në pjesën fundore uniformisht.
- Të bëjë përgatitjen përfundimtare të buqetave duke i mbështjellë me letër apo rrjeta të llojeve e ngjyrave të ndryshme, e lidhur me fjongo me forma e ngjyra të ndryshme.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e përgatitjes së buqetave me lule natyrale të freskëta.
- Të tregojë kujdes nga veglave dhe materialeve të punës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë përgatitjes së buqetave me lule natyrale të freskëta.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së buqetave me lule natyrale të freskëta.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi krijon buqeta me lule natyrale të freskëta në vazo.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të përgatitë vendin dhe mjetet e nevojshme të punës për përgatitjen e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të përzgjedhë llojet dhe madhësinë e vazove për krijimin e buqetave me lule natyrale të freskëta.
- Të sigurojë lule të ngjyrave të ndryshme dhe materialeve të ndryshme vegjetative.
- Të shtrojë tavolinën e punës për përgatitjen e buqetave me lulenatyrale në vazo.
- Të vendosë me kujdes vazot në tavolinë.
- Të mbushë vazon me materiale të ndryshme si sfungjerë, bukë peshku, guriçka, rërë, zhavorr, mbeturina bimore etj.
- Të vendosë materialin vegjetativ dhe lulet në vazo sipas kërkesës dhe modelit të kompozuar.
- Të përcaktojë seksionet midis luleve e gjetheve sipas një raporti të drejtë midis tyre.
- Të rregullojë volumin e buqetës në vazo me gjethe të gjelbra të formave të ndryshme.
- Të bëjë përgatitjen përfundimtare e buqetave me lule natyrale të freskëta në vazo duke bërë zbukurimin e

tyre me letër apo rrjetë dekorative.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e përgatitjes së buqetave me lule natyrale në vazo pas krijimit të tyre.
- Të tregojë kujdes ndaj veglave dhe pajisjeve të punës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë krijimit tëbuqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë krijimit tëbuqetave me lule natyrale të freskëta në vazo.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi krijon buqeta me lule të thata në shporta.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- Të veshë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse të punës.
- Të përgatitë vendin dhe mjetet e nevojshme të punës për përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta.
- Të përzgjedhë llojet dhe madhësinë e shportave për krijimin e buqetave me lule thata, sipsa kërkesës.
- Të sigurojë lule të thata të ngjyrave të ndryshme dhe materialeve të ndryshme bimore sipas modelit të kompozuar.
- Të shtrojë tavolinën e punës për përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta.
- Të vendosë me kujdes shportat në tavolinë.
- Të mbushë shortën me materiale të ndryshme si sfungjerë, bukë peshku,  mbeturina bimore të thata, myshk i thatë etj.
- Të vendosë materialin bimor lulet  të thara në shporta sipas kërkesës dhe modelit të kompozuar.
- Të bëjë përgatitjen përfundimtare e buqetave me lule të thata në shporta duke bërë zbukurime shtesë sipas kë sipas kërkesës.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e përgatitjes së buqetave me lule të thata në shporta pas krijimit të tyre.
- Të tregojë kujdes ndaj veglave dhe pajisjeve të punës.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë krijimit të buqetave me lule të thata në shporta.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë krijimit të buqetave me lule të thata në shporta.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | | |
|---|---|---|
| | **RM 4** | **Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për për përdorimin e luleve të freskëta dhe të thara.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– të përgatisë fletë kërkesën për bazën materiale që nevojitet për përdorimin e luleve të freskëta dhe të thara.<br>– të hartojë preventivin e shpenzimeve sipas manualit perkatës.<br>– të njehsojë koston e bazën materiale që nevojitet për për përdorimin e luleve të freskëta dhe të thara, sipas manualit përkatës.<br>– të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.<br>– të njehsojë kostot e tjera (transport, makineri, paisje, etj.), sipas manualit përkatës.<br>– të llogarisë detyrimet fiskale për përdorimin e luleve të freskëta dhe të thara.<br>– të komunikojë me etikë profesionale.<br>– të përdorë TIK-un gjatë përdorimit të luleve të freskëta dhe të thara për përgatitjen e buqetave me lule.<br>– të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për kultivimin e kulturave kopshtare.<br>***Instrumentet e vlerësimit:***<br>– Vëzhgim me listë kontrolli. |
| **Udhëzime për zbatimin e modulit** | | – Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në bazën prodhuese të shkollës dhe në pikat e tregëtimit të luleve natyrale të freskëta.<br>– Instruktori i praktikës ose specialisti i përgatitjes së buqetave duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për përgatitjen e luleve natyrale të freskëta në buqeta e në vazo, përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta, si dhe të llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me këto punime.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për përgatitjen e luleve natyrale të freskëta në buqeta e në vazo, përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta.<br>– Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete për kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike për përgatitjen e buqetave me lule natyrale të freskëta dhe përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta, si dhe në llogaritje të thjeshta ekonomuke lidhur me to<br>– Instruktori i praktikës ose specialisti i përgatitjes së buqetave duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve dhe materialeve për pergatitjen e buqetave me lule natyrale të freskëta dhe përgatitjen e buqetave me lule të thata |

| | |
|---|---|
| | në shporta, si dhe llogaritjeve të thjeshta ekonomike lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës ose specialisti i përgatitjes së buqetave duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së buqetave me lule natyrale te fresketa dhe përgatitjen e buqetave me lule të thata në shporta.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për përgatitjen e buqetave me lule. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:<br>– Baza prodhuese e shkollës ose pikë tregtimi lulesh.<br>– Tavolina për përgatitjen e buqetave.<br>– Lule natyrale të freskëta të ngjyrave të ndryshme<br>– Lule të thata të ngjyrave të ndryshme.<br>– Materiale bimore të ndryshme natyrale të freskëta dhe të thata.<br>– Mjete dhe materiale për zbukurimin e buqetave si; letër e rrjetë dekorative, lidhëse të ndryshme, fjongo, kapëse, tela, fije, shirita zbukurues etj,<br>– Pankarta, udhëzues, katalogë, rregullore, standarde buqetash, etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e përgatitjes së buqetave (kodi i punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumentacionit financiar dhe fiskal. |

## 3. Moduli: “Mbjellja e kulturave kopshtare në objekte rrethanore”

**Drejtimi: Bujqësi**
**Profili: Kopshtari**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

*PERSHKRUESI I MODULIT*

<table>
<tr><td>Titulli dhe kodi</td><td colspan="2">MBJELLJA E KULTURAVE KOPASHTARE NË OBJEKTE RRETHANORE</td><td>M-14-913-20</td></tr>
<tr><td>Qëllimi i modulit</td><td colspan="3">Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të përdorur vazo të ndryshme për ballkone e dritare, objekte të vjetëruara shtëpiake për mbjelljen e luleve e bimëve dekoratike, si dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike lidhur me to.</td></tr>
<tr><td>Kohëzgjatja e modulit</td><td colspan="3">51 orë mësimorë</td></tr>
<tr><td>Niveli i parapëlqyer për pranim</td><td colspan="3">Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”.</td></tr>
<tr><td>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe proçedurat e vlerësimit</td><td>RM 1</td><td colspan="2">Nxënësi përdor vazo të ndryshme për mbjelljen e luleve dhe bimëve dekorative për ballkone e dritare.<br>Kriteret e vlerësimit:<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– Të veshë uniformën e duhur dhe pajisjet mbrojtëse të punës.<br>– Të interpretojë modele të thjeshta të kompozimit të luleve dhe bimëve dekorative në ballkon e dritare, duke analizuar të gjithë elementët estetik të tyre.<br>– Të analizojë pozicionin gjeografik dhe faktorët klimatik ku ndodhet ballkoni apo dritarja.<br>– Të përgatitë preventivin e materialeve bazë, si vazo, lule (larmia dhe sasia), bimë dekorative (larmia dhe sasia) dhe materialeve ndihmëse (dherishtja e gatshme ose plehu organik me dhè), lidhëse, sistem mbështetës, sistem i ujitjes me pika etj), veglat e punës etj., për mbjelljen e luleve dhe bimëve dekorative në ballkone e dritare.<br>– Të përcaktojë llojin dhe sasinë e luleve dhe bimëve dekorative për tu mbjellë në vazo për ballkone e dritare, sipas preventivit.<br>– Të përzgjedhë vazo të ndryshme plastike, metalike, prej druri, formë katrore, drjetkëndëshe, rrethore, të vogla mesatare të mëdha, me zbukurime ose jo, sipsa llojit të</td></tr>
</table>

bimës, vendit ku do të vendoset vazoja, si dhe sipas modelit kompozues të kërkuar për ballkone e dritare.

- Të përzgjedhë mjetet dhe materialet ndihmëse të nëvojshme për mbjelljen e luleve dhe bimëve dekorative në vazo për ballkone e dritare.
- Të përcaktojë llojet dhe sasinë e luleve dhe bimëve dekorative për tu mbjellë në vazo për ballkone e dritare, sipas orientimit të tyre gjeografik.
- Të përgatitë dherishten për mbushjen e vazove në raportin e caktuar të dheut me plehun organik, ose ta blejë atë të gatshme në dyqanet e tregëtimit të luleve.
- Të mbushë vazot me gjysmën e vazos me dherishten e përgatitur apo blerë.
- Të vendosë fidanin/ copën e lules apo bimës dekorative në mes të vazos gjysëm të mbushur.
- Të mbushë gjysmën tjetër të vazos me dherishte me kujdes.
- Të bëjë ngjeshjen e lehtë të dherishtes në vazo për të rritur kontaktin e bimës me dherishten.
- Të ujisë bimën në vazo menjëherë pas mbjelljes për të siguruar lagështirën e nevojshme për të.
- Të vendosë me kujdes vazot e mbjella, në ballkon apo dritare, sipas modelit të kompozuar.
- Të pastrojë siç duhet vendin dhe mjetet e punës pas mbjelljes së bimëve dekorative në vazo.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të kostos, shpenzimeve dhe punës së kryer, për mbjelljen e luleve dhe bimëve dekorative në vazo për ballkone dhe dritare.
- Të kujdeset siç duhet për mirëmbajtjen e veglave dhe materialeve të punës pas mbjelljes së luleve dhe bimëve dekorative në vazo për ballkon dhe dritare.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë mbjelljes së luleve dhe bimëve dekorative në vazo për ballkone dhe dritare.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbjelljes së luleve dhe bimëve dekorative në vazo për ballkone e dritare.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi përdor objekte rrethanore për mbjelljen e kulturave kopshtare.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën dhe pajisjet e duhura mbrojtëse për

përdorimin e objekteve rrethanore në mbjelljen e kulturave kopshtare.
- Të grumbullojë objekte rrethanore të vjetëruara të ndryshme, për mbjelljen e kulturave kopshtare si: karroca dore, goma makinash, qypa të dëmtuar, legen të prishur, këpucë të dëmtuara, tenxhere etj..
- Të përzgjedhë mjetet dhe materialet e tjera ndihmëse për mbjelljen e kulturave kopshtare në objekte rrethanore të vjetëruara.
- Të lyejë me ngjyra dhe dekorojë sipas dëshirës dhe treguesve estetik, objekteve rrethanore të vjetëruara të përzgjedhura në harmoni të plotë me mjedisin përreth.
- Të përcaktojë llojet dhe sasinë e kulturave kopshtare për tu mbjellë në përputhje me formën dhe madhësinë e objekteve rrethanore të vjetëruara.
- Të përcaktojë vendin e përhershëm të vendosjes së objektit rrethanor të vjetëruar, në përputhje me mundësitë që ofron mjedisi.
- Të përgatitë dherishten për mbushjen e objekteve rrethanore në sasinë dhe cilësinë e duhur.
- Të mbjellë kulturat kopshtare në objekte rrethanore të vjetëruara sipas teknikës së mbjelljes.
- Të ngjeshë lehtë dherishten në objektin rrethanor të vjetëruar për të rritur kontaktin e kulturës kopshtare me dherishten.
- Të ujisë kulturat kopshtare menjëherë pas mbjelljes së tyre.
- Të kujdeset vazhdimisht gjatë rritjes së kulturave kopshtare në objektet rrethanore të vjetëruara: capitje, plehërime, ujitje etj.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas mbjelljes s së kulturave kopshtare në objektet rrethanore të vjetëruara.
- Të kujdeset siç duhet për veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të kryejë llogaritjen e kostove dhe e shpenzimeve të përdorimit të objekteve rrethanore të vjetëruara.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë mbjelljes së kulturave kopshtare në objekte rrethanore të vjetëruara .
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të objekteve rrethanore të vjetëruara për mbjelljen e kulturave kopshtare.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | – Ky modul duhet të trajtohet në shkollë ose në hapësira të caktuara publike pranë shkollës.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimit të vazove të ndryshme për mbjelljen e luleve dhe bimëve dekorative për ballkone e dritare, të përdorimit të objekteve rrethanore të vjetëruara për mbjelljen e kulturave kopshtare,si dhe të llogaritjes së kostos, shpenzimeve dhe punës së kryer në përdorimin e vazove dhe objekteve të tjera rrethanore.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune të përdorimit të vazove të ndryshme për mbjelljen e luleve dhe bimëve dekorative për ballkone e dritare, të përdorimit të objekteve rrethanore të vjetëruara për mbjelljen e kulturave kopshtare,si dhe të llogaritjes së kostos, shpenzimeve dhe punës së kryer në përdorimin e vazove dhe objekteve të tjera rrethanore, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.<br>– Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me përdorimin e vazove të ndryshme për mbjelljen e luleve dhe bimëve dekorative për ballkone e dritare, përdorimin e objekteve rrethanore të vjetëruara për mbjelljen e kulturave kopshtare, si dhe me llogaritjen e kostos, shpenzimeve dhe punës së kryer në përdorimin e vazove dhe objekteve të tjera rrethanore.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e mbjelljes së luleve e bimëve dekorative në vazo të ndryshme për ballkone e dritare, të përdorimit të objekteve rrethanore të vjetëruara për mbjelljen e kulturave kopshtare, si dhe të llogaritjes së kostos, shpenzimeve dhe punës së kryer në përdorimin e vazove dhe objekteve të tjera rrethanore.<br>– Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen fermë bujqësorë, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:<br>– Uniforma dhe pajisjet mbrojtëse të punës<br>– Objekte të vjetëruara si karroca dore, goma , qypa, enë të ndryshme të vjetëruara etj.<br>– Vazo të ndryshme.<br>– Pleh organik, dhè dhe dherishte<br>– Vegla të thjeshta pune për përgatitjen e dherishtes dhe mbjelljen e bimëve.<br>– Kotalogë dhe manuale të ndryshme të mbjelljes së kulturave kopshtare në vazo dhe objekte rrethanore të vjetëruara. |

| | |
|---|---|
| | – Pamje filmike të proceseve të punës gjatë përdorimit të vazove e objekteve të vjetëruara shtëpiake për mbjelljen kulturave kopshtare.<br>- Materiale kancelarie.<br>- Legjislacioni.<br>– Materiale udhëzuese |

**4. Moduli: “Teknika e shtimit me copa të kulturave kopshtare”**

**Drejtimi: Bujqësi**
**Profili: Kopshtari**
**Niveli: III i KSHK**
**Klasa: 12**

*PERSHKRUESI I MODULIT*

| | | |
|---|---|---|
| **Titulli dhe kodi** | **TEKNIKA E SHTIMIT ME COPA TË KULTURAVE KOPSHTARE** | **M-14-1685-20** |
| **Qëllimi i modulit** | Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të zbatuar teknikën e shtimit me copa të ndryshme të kulturave kopshtare në vazo ose tokë dhe ambiente të mbrojtura në bango rrënjëzuese, luleshtrydhes si dhe të kryerjes së llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me to. | |
| **Kohëzgjatja e modulit** | 51 orë mësimore | |
| **Niveli i parapëlqyer për pranim** | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Bujqësi”. | |
| **Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe proçedurat e vlerësimit** | **RM 1** | **Nxënësi shton me copa vegjetative bimët zbukuruese në vazo ose tokë.**<br>***Kriteret e vlerësimit:***<br>Nxënësi duhet të jetë i aftë:<br>– Të veshë uniformën e duhur dhe pajisjet mbrojtëse të punës.<br>– Të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme pë shtimin me copa të bimëve zbukuruese.<br>– Të përcaktojë llojin dhe sasinë e copave të bimëve zbukuruese që do të shtohen.<br>– Të përzgjedhë mjetet dhe materialet ndihmëse për shtimin me copa të bimëve zbukuruese.<br>– Të përgatisë dherishten për mbushjen e vazove ose në mbjelljen në tokë (p.sh coptore) në raportin e caktuar të dheut me plehun organik ose ta blejë atë të gatshme në dyqanet e tregëtimit të luleve.<br>– Të kryejë mbushjen e vazove ose në mbjelljen në tokë me dherishten e përgatitur apo të blerë.<br>– Të përgatisë tretësirën për trajtimin e copave.<br>– Të kryejë trajtimin e copave me tretësirën rrënjëformuese.<br>– Të kryejë vendosjen e copave të bimëve në mes të vazos ose vendin e projektuar në mbjelljen ne tokë.<br>– Të kryejë ngjeshjen e lehtë të dherishtes në vazo ose të |

tokës për të rritur kontaktin e copës së bimës me dherishten.
- Të kryejë ujitjen e copave në vazo menjëherë pas mbjelljes për të siguruar lagështirën e nevojshme për rrënjëzim.
- Të kryejë shërbime të ndryshme pas mbjelljes së copave.
- Të pastrojë siç duhet vendin dhe mjetet e punës pas mbjelljes së copave të bimëve zbukuruese në vazo ose tokë.
- Të kujdeset siç duhet për mirëmbajtjen e veglave dhe materialeve të punës gjatë shtimit me copa të bimëve zbukuruese në vazo ose tokë.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë shtimit me copa të bimëve zbukuruese në vazo ose tokë.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtimit me copa të bimëve zbukuruese në vazo ose tokë.

***Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 2 Nxënësi shton me copa vegjetative kulturat drufrutore në vazo ose tokë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- Të përzgjedhë veglat, paisjet dhe materialet e nevojshme për shtimin me copa të drufrutorëve.
- Të përzgjedhë vendin për shtimin me copa të drufrutorëve.
- Të përcaktojë radhën e punës për shtimin me copa të drufrutorëve në toka.
- Të kryejë marrjen e copave të drufrutorëve.
- Të përgatitë tretësirën rrënjëformuese.
- Të trajtojë copat me tretësirën rrënjëformuese.
- Të përgatisë dherishten për vendosjen e copave.
- Të përgatisë vendin ose vazove për shtimin me copave të drufrutorëve.
- Të vendosë copat për rrënjëzim.
- Të mbushë gropat  me pleh e dhe.
- Të kryejë mbjelljen e drufrutorëve.
- Të kryerjë shërbimet menjëherë pas mbjelljes së copave të drufrutorëve: ujitje, kontrolli i rrënjëzimit të copave, etj.
- Të kryerjë shërbimet agroteknike gjatë periudhës së vegjetacionit: ujitje, plehrime, punime, kujdesi për

shëndetësimin e copave të rrënjëzuar etj.

- Të pastrojë vendin, pas kryerjes së çdo hapi agroteknologjik gjatë shtimit me copa të drufrutorëve.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë shtimit me copa të drufrutorëve.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm gjatë shtimit me copa të drufrutorëve.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë shtimit me copa të drufrutorëve në kopshtin familjar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 3 Nxënësi shton me copa vegjetative kulturat kopshtare në ambiente të mbrojtura në bangon rrënjëzuese ose kaseta (module) të ndryshme.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të veshë uniformën e punës.
- Të përzgjedhë veglat, materialevet dhe pajisjet për shtimin me copa të kulturës kopshtare në ambjente të mbrojtura në bango rrënjëzuese.
- Të përgatitë infrastrukturën teknike të bangos rrënjëzuese për shtimin e kulturve kopshtare në shtrat drejtpërdrejtë ose krijimin e shtretërve për vendosjen e kasetave.
- Të përzgjedhë materialet për krijimin e bangos rrënjëzuese me lëndë të ndryshme si çimento, tulla, dërrasa, fletë alumini etj.
- Të ndërtojë bangon rrënjëzuese me parametrat teknik të përcaktuar më parë në preventiv.
- Të përgatitë sistemin e hidromjegullimit, sipas preventivit, për mbjelljen drejtpërdrejtë në bangon rrënjëzuese.
- Të përgatitë substraktin e rrënjëzimit dhe sterilizimit i tyre, për shumicën e bimëve në bangon e rrënjëzimit është 100% perlit ose vermikulit, ndërsa në vazo është përzierja torfë/perlit ne raport 1:1.
- Të përcaktojë llojin të kulturave kopshtare që do të shtohet në ambjente të mbrojtura në bango rrënjëzuese.
- Të përzgjedhë mjetet dhe materialet ndihmëse për shtimin me copa të kulturave kopshtare.
- Të përgatitë substraktin ushqyes për mbushjen e vazove dhe bangos së rrënjëzimit ku do të mbillet kultura kopshtare.
- Të mbushë vazot me substraktit ushqyes.

- Të përgatitë vendin e bangos së rrënjëzimit ku do të mbillet kultura kopshtare.
- Të përgatitë substraktin ushqyes 100% perlit ose vermikulit, ndërsa torfe/perlit në raport 1:1 kur mbjellja bëhet në vazo.
- Të përgatitë dhe trajtojë copat për tu vendosur në bangon e rrënjëzimit.
- Të ngjeshë lehtë substraktin ushqyes në vazo ku janëmbjellë kulturat kopshtare.
- Të vendosë copat në shtratin e bangos në substraktin ushqyes drejtëpërdrejt në shtratin e bangos rrënjëzuese. ose të vazove të mbjella me substraktin rrënjëzues në shtratin e bangos.
- Të ujisë copat e kulturave kopshtare, pas mbjelljes me sistemin e hidromjegullimit në mbjelljen e drejtëpërdrejtë të bangos rrënjëzuese ose nga poshtë ose hidromjegullim për mbjelljet në vazo.
- Të kryejë shërbime të tjera pas rrënjëzimit të copave, sipas udhëzimeve përkatëse.
- Të shkulë dhe seleksionojë fidanët e rrënjëzuar sipas standardit.
- Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas mbjelljes së copave në ambientet e mbrojtura në shtratin e bangos rrënjëzuese.
- Të tregojë kujdes për mirëmbajtjen e veglave dhe materialeve të punës pas mbjelljes së copave në ambientet e mbrojtura në shtratin e bangos rrënjëzuese.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm me eprorët, klientët dhe kolegët gjatë shtimit me copa kulturave kopshtare në ambientet e mbrojtura në shtratin e bangos rrënjëzuese.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shtimit me copa të kulturave kopshtare në ambientet e mbrojtura në shtratin e bangos rrënjëzuese.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi shton me lastunja ose stolone luleshtrydhen.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë veglat, paisjet dhe materialet e nevojshme për shtimin me lastunja të luleshtrydhes.
- Të përzgjedhë vendin për shtimin me lastunja të luledhtrydhes.
- Të përcaktojë radhën e punës për shtimin me lastunja.
- Të kryejë marrjen e lastunjave sipas standartit .

- Të kryejë përgatitjen e dherishtës sipas standartit.
- Të kryejë përgatitjen  e vendit ose vazove për shtimin me lastunja te luleshtrydhes .
- Të kryejë vendosjen e lastunjave për rrënjëzim.
- Të kryerjë shërbimet menjëherë pas mbjelljes së lastunjave: ujitje, kontrolli i rrënjëzimit të copave, etj.
- Të kryerjë shërbimet agroteknike gjatë periudhës së vegjetacionit: ujitje, punime, plehrime, kujdesi për shëndetësimin e lastunjave të rrënjëzuar  etj.
- Të pastrojë vendin, pas kryerjes së çdo hapi agroteknologjik gjatë shtimit me lastunja të luleshtrydhes.
- Të kujdeset për mirëmbajtjen e veglave, pajisjeve dhe materialeve gjatë shtimit me lastunja.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 5 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike gjatë teknikës së shtimit me copa të kulturave kopshtare**.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përgatisë fletë kërkesën për bazën materiale që nevojitet për shtimin me copa të kulturave kopshtare.
- Të hartojë preventivin e materialeve bazë për shtimin me copa të kulturave kopshtare në vazo, tokë ose në ambjente të mbrojtura në bango rrënjëzuese.
- Të njehsojë koston e bazës materiale që nevojitet për shtimin me copa të kulturave kopshtare, sipas manualit përkatës.
- Të njehsojë koston e punës (pagat, tatimet, sigurimet shoqërore, etj.), sipas manualit përkatës.
- Të njehsojë kostot e tjera (transport, makineri, paisje, etj.), sipas manualit përkatës.
- Të llogarisë detyrimet fiskale për shtimin me copa të kulturave kopshtare.
- Të llogarisë të ardhurat dhe fitimin në një biznes të vogël për shtimin me copa të kulturave kopshtare.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

| | |
|---|---|
| **Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.** | – Ky modul duhet të trajtohet në ngastra të vogla në bazën prodhuese të shkollës ose në zonat përreth.<br>– Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të punës për zbatimin e hapave agroteknologjik të shtimit me copa të |

| | |
|---|---|
| | kulturave kopshtare bimëve zbukuruese, drufroturë, luleshtrydhes në vazo ose tokë dhe në ambiente të mbrojtura në bango rrënjëzuese, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.<br>– Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e hapave agroteknologjik të shtimit me copa të kulturave të ndryshme kopshtare në vazo ose tokë dhe në ambiente të mbrojtura në bango rrënjëzuese, si dhe llogaritjen ekonomike të kostove të punimeve lidhur me to.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë përdorimin dhe mirëmbajtjen e veglave, mjeteve për kryerjen e hapave agroteknologjik të shtimit me copa të kulturave të ndryshme kopshtare në vazo ose tokë dhe në ambiente të mbrojtura në bango rrënjëzuese.<br>– Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së veglave dhe pajisjeve të punës së kopshtarisë.<br>– Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për shtimin me copa të kulturave kopshtare. |
| **Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit** | Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohet ngastra e tokës bujqësore, veglat, pajisjet, dhe makineria e mëposhtme:<br>– Ngastër toke në bazën prodhuese të shkollës.<br>– Vegla dhe pajisje pune për shtimin me copa të kulturave kopshtare.<br>– Material mbjellës të kulturave kopshtare.<br>– Bimë të ndryshme.<br>– Copa rrënjore. copa gjethore, copa kërcellore.<br>– Dherishte, pleh organik.<br>– Vazo.<br>– Substrakte rrënjëzuese (perlit, vermikulit, torfe etj).<br>– Kaseta (module) të ndryshme.<br>– Materiale për përgatitjen e bangove rrënjëzuese **si** çimento, tulla ,dërrasa, fletë alumini etj.<br>– Materiale për sistemin e ujitjes me hidromjegullim.<br>– Tretësirë të acidit naftalacetik,indolbutirik.<br>– Pamje filmike të proceseve të punës shtimit me copa të kulturave kopshtare.<br>– Pankarta, skica, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.<br>– Pajisje kancelarie.<br>– Makina llogaritëse dore.<br>– Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.<br>– Përmbledhje e legjislacionit në fushën e kopshtarisë (kodi i |

| | |
|---|---|
| | punës, legjislacioni fiskal).<br>– Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal. |